

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5966  
E shtunë, 28 dhjetor 2019  
çmimi 0.40 €

FSK-ja vitin e parë  
si ushtri e përmbylli  
suksesshëm | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAJ | FAQE 4-5

# KOSOVA ËSHTË NË KRIZË POLITIKE



Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se vendi ka hyrë në krizë politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo po ndodh për shkak se partnerët e koalicionit LV dhe LDK nuk kanë mirëbesim mes

vete për ta formuar qeverinë e ardhshme. Hoxhaj ka thënë se u takon LV-së dhe LDK-së t'i formojnë institucionet pasi ato janë deklaruar publikisht para qytetarëve për një gjë të tillë. Ai ka thënë se në 20 vjetët e fundit Kosova është dëmtuar me qeveri me mandat afatshkurtër.

Hoxhaj ka thënë se vendi nuk duhet të shkojë sërish në zgjedhje të reja. "Nuk mendoj se më 6 tetor qytetarët kanë dalë në zgjedhje për të mbajtur sërish zgjedhje të parakohshme. Qytetarët presin që të ketë institucione të reja dhe të mos blihet kohë", është shprehur Hoxhaj

## OPINION

SITUATA REALE  
NË KOSOVË DHE  
MIOPIA POLITIKE  
E RAMËS F. 8

Nga Bedri ISLAMI



MIGRANTËT DHE EVROPA F. 11

Shkruan:  
Mentor TAHIRI



## AKTUALE



HYSENI TREGON TË ARRITURAT  
E 2019-s DHE SFIDAT QË E  
PRESIN KPK-në NË 2020 F. 3

## EKONOMI



TELEKOMI I KOSOVËS: MINISTRI  
LLUKA RREZIKON SIGURINË  
NACIONALE F. 9

FILLUAN PUNIMET PËR  
RENOVININ E ZYRAVE TË AKP-së  
F. 9

## SPORT

LORIANËS I NGRITËT PËR  
350 DOLLARË BURSA OLIMPIKE F. 20

Meta nderon  
Pacoli me  
urdhrin e lartë  
'Nënë Tereza'

Kurti shmang takimin me  
Thaçin për ta marrë mandatin



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka refuzuar të premtën dy ftesa të presidentit Hashim Thaçi për takim konsultativ për ta marrë zyrtarisht mandatin për formimin e qeverisë së re. Fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit ka bërë me dije se në takimet me presidentin nuk ka mundur të marrë pjesë për shkak se gjendet jashtë vendit. Njohësit e proceseve politike kanë treguar se Kurti po e shmang takimin me Thaçin për të blerë kohë në mënyrë që mos të fillojë të rrjedhë afati kushtetues prej 15 ditësh për formimin e qeverisë | FAQE 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: Tensioni politik në Shqipëri e Kosovë është i provokuar qëllimisht

TIRANË, 27 DHJETOR - Presidenti Ilir Meta, në një intervistë për emisionin "360 gradë" të Artur Zhejit, deklaroi se situata politike në Shqipëri është tensionuar qëllimisht nga një person i vetëm, duke nënkuptuar Edi Ramën.

"Tensioni në Shqipëri nuk është i rastësishëm, por i sponsorizuar dhe i provokuar qëllimisht. Ky tension qëndron në arbitraritetin e një individi që ka rrezuar për fat të keq një sistem të tërë të shtetit ligjor dhe të së drejtës. Këtë situatë po e shfrytë-



zon për fat të keq Serbia për t'i pasqyruar shqiptarët në botë, si në Shqipëri dhe në Kosovë, si një popull të paafte për të ndërtuar

shtet. Politika serbe për fat të keq ka avancuar shumë", tha presidenti Meta.

Presidenti Meta i cilësoi provokime të qëllimshme dhe deklaratat e Edi Ramës për Kosovën. Ai solli në vëmendje deklaratën e Edi Ramës për president të përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës. "Përse duhet një deklaratë e tillë? Më e pakta serbët e përdorin dhe thonë përse duhet ta njihni Kosovën të pavarur, këta do bashkohen me Shqipërinë", tha ai.

Presidenti Ilir Meta e ka cilësuar

të papranueshme deklaratën e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq për mohimin e Masakrës së Reçakut. Kreu i shtetit u shpreh se "është e papranueshme të thuash qëllimisht e Reçakut ishte një trillim, sepse kjo do të thotë se ti mohon një gjenocid të kryer në zemër të Evropës. Kjo nuk mund të pranohet, sepse nesër ai mund të thotë se Srebrenica nuk ka ekzistuar, etj, dhe kjo nuk mund të pranohet. Ai nuk duhet të provokojë shqiptarët dhe bashkëpunimin rajonal".

## Mosmiratimi i ligjeve në pikëpyetje zgjedhjet në Maqedoni të Veriut

Kryeministri Zoran Zaev, disa herë ka paralajmëruar opozitën që drejtohet nga VMRO-DPMNE-ja, e cila në forma të ndryshme, qoftë duke pamundësuar sigurimin e kuorumit të nevojshëm apo përmes ndërhyrjeve të shumta procedurale, ka bërë që kuvendi të mos miratojë dhjetëra propozim-ligje të sferave të ndryshme

SHKUP, 27 DHJETOR - Nëse deri në afatin për formimin e qeverisë teknike, më 3 janar, nuk miratohen disa ligje që për Qeverinë e Maqedonisë së Veriut janë shumë të rëndësishme, atëherë vihet në pikëpyetje mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, më 12 prill të vitit të ardhshëm.


Kështu kryeministri maqedonas, Zoran Zaev, disa herë ka paralajmëruar opozitën që drejtohet nga VMRO-DPMNE-ja, e cila në forma të ndryshme, qoftë duke pamundësuar sigurimin e kuorumit të nevojshëm apo përmes ndërhyrjeve të shumta procedurale, ka bërë që kuvendi të mos miratojë dhjetëra propozim-ligje të sferave të ndryshme.

Për qeverinë me rëndësi janë propozimet për rritjen e pagave,

rritjen e pensioneve, disa zgjidhje tjera për subvencione, pastaj propozim-ligji për armatën e tjera.

"VMRO DPMNE-ja dhe Hristijan Mickovski po vazhdojnë me sjelljen e tyre destruktive në dëm të interesave të qytetarëve dhe të shtetit. Me bllokimin e vetëdijshëm të Ligjit për mbrojtje, ata po e shkelin Kushtetutën duke rrezikuar realizimin e ëndrrës disa dekadëshe për anëtarësimin e vendit në NATO. Ata po rrezikojnë veto të re nga Republika e Greqisë, në veçanti tani kur ratifikimi i protokollit për anëtarësimin e plotë të vendit në këtë aleancë është në fund", ka deklaruar Hari Lokvenec nga Lidhja Social-Demokrate.

Propozim-ligji për mbrojtjen



parashih ndërrimin e emrit të armatës në "Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut", por këtë emër opozita nuk e njeh.

"Republika e Maqedonisë ndodhet në një situatë jashtëzakonisht të rëndë. Interesat shtetërore dhe të qytetarëve duhet të vendosen mbi interesat partiake dhe personale. Populli pret shpresë, shans për jetë më të mirë. Lufta jonë është për përparimin e shtetit, për parime, për vlera dhe për ripërtëritjen e Maqedonisë dhe jo për masa populiste në

shërbim të partisë", ka deklaruar Igor Janjushev, sekretari i përgjithshëm i VMRO-DPMNE-së, parti kjo e cila në mbledhjen e organeve partiake, të enjten, në mbrëmje ka nominuar kryetarin e saj, Hristijan Mickovski, si kandidat për kryeministër në zgjedhjet e 12 prillit, edhe pse ato vazhdojnë të mbeten pezull për shkak të bllokimit të ligjeve.

Partitë shqiptare, pa përjashtim janë kundër çdo shtyrje të zgjedhjeve, pasi sipas tyre për datën janë marrë vesh liderët e të gjitha

partive, të cilët duhet t'i përmbahen afatit të paraparë më 12 prill. "Unë nuk shoh se mund të ketë ndonjë arsye për shtyrjen e datës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Ato janë vendosur me konsensus nga të gjithë liderët, por sikur të ketë ndonjë ndryshim ai duhet të miratohet me konsensus të përbashkët", ka deklaruar Izet Mexhiti, nënkryetar i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Kryeministri, Zoran Zaev, të shtunën, do të takohet me liderin e opozitës, Hristijan Mickovski dhe kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti. Nuk dihet nëse në këtë takim do të vulozet 12 prilli si datë e zgjedhjeve, apo nëse do të vendoset për shtyrjen e tyre. Këto parti do të do të jenë pjesë e qeverisë teknike, pa Zoran Zaevin kryeministër, andaj edhe nuk përjashtohet mundësia që në këtë takim të merren vesh për emrat e rinj të kësaj qeverie që do të drejtohet nga një kuadër i LSDM-së. Mandati i qeverisë në të cilin VMRO-ja do të drejtojë dy ministri, ka për qëllim organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

## Protestë para Ambasadës së Malit të Zi në Beograd

BEOGRAD, 27 DHJETOR - Disa qindra njerëz kanë protestuar të premten para Ambasadës së Malit të Zi në qendër të Beogradit, për të kundërshtuar miratimin e Ligjit për Lirinë Fetare nga ana e Parlamentit të Malit të Zi.

Protesta është organizuar nga Klubi Studentor i Fakultetit të Drejtësisë në Beograd.

Po të njëjtën ditë, para Ambasadës malaziasë në Beograd u organizua gjithashtu

një miting kundër Ligjit për Lirinë Fetare, i organizuar nga lëvizja opozitare Dveri e udhëhequr nga Boshko Obradović.

Deputeti, Obradović u përlesh fizikisht me deputetët e pozitës në Parlamentin e Serbisë, pasi gjatë seancës, hyri me një pankartë në duar, për të protestuar ndaj faktit që Serbia nuk ka reaguar për miratimin e këtij ligji. Parlamenti i Malit të Zi ka miratuar një projektligj për komunitetet fetare, i cili është

kundërshtuar nga opozita pro-serbe, duke ngritur shqetësimin se ky dokument mund t'i heqë Kishës Ortodokse Serbe të drejtën mbi pronësinë e pronave që administrojnë.

Të enjten, qindra mbështetës të opozitës pro-serbe kanë dalë në rrugët e kryeqytetit, Podgoricë për të kundërshtuar projektligjin.

Kisha Ortodokse Serbe pretendon se ligji do t'i marrë asaj pronën, duke përfshirë



manastiret dhe kishat, andaj planifikon të dërgojë ankesë në organizatat ndërkombëtare.

Zyrtarët malazias kanë mohuar supozimin që kisha do të humbasë pronën që ka.

Takimi i shumëpritur në mes të Hashim Thaçit dhe Albin Kurtit ende nuk ka ndodhur

# Kurti shmang takimin me Thaçin për ta marrë mandatin

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka refuzuar të premtën dy ftesa të presidentit Hashim Thaçi për takim konsultativ për ta marrë zyrtarisht mandatin për formimin e qeverisë së re. Fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit ka bërë me dije se në takimet me presidentin nuk ka mundur të marrë pjesë për shkak se gjendet jashtë vendit. Njohësit e proceseve politike kanë treguar se Kurti po e shmang takimin me Thaçin për të blerë kohë në mënyrë që mos të fillojë të rrjedhë afati kushtetues prej 15 ditësh për formimin e qeverisë

**EPOKA ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premtën dy herë ka ftuar në takimin konsultativ liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ta mandatojë për kryeministër, por ky i fundit ka refuzuar të shkojë në Presidencë. Fituesi i zgjedhjeve të 6 tetorit, Albin Kurti, ka treguar se për shkak se gjendet jashtë vendit nuk ka mundur t'u përgjigjet pozitivisht ftesave të presidentit. Fillimisht, presidenti Thaçi e kishte ftuar Kurtin për takim në orën 13:30, ndërsa LV-ja kishte bërë me dije se nuk mund të ndodhë një takim i tillë sepse Kurti gjendet jashtë Prishtinës.

Nuk ka vonuar shumë dhe presidenti Thaçi sërish e ka ftuar

Kurtin për takimin e dytë në orën 20:00 të së premtës. "Siç e kam cekur edhe në ftesën e parë, në pajtim me nenin 84(14) dhe nenin 95.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do t'i ndërmarr hapat e përcaktuar në Kushtetutë për ta caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pasi që zyrtarisht nuk kam pranuar asnjë arsyetim për mungesën tuaj në takimin e orës 13:30, ju ftoj sërish për takim sonte, në orën 20:00, dt. 27 dhjetor 2019, në kabinetin e Presidentit të Republikës së Kosovës", është thënë në ftesën e dytë të presidentit për liderin e LV-së.

Në mbrëmjen e së premtës, lideri i LV-së ka bërë me dije se ndodhet jashtë vendit dhe nuk mund të takohet.

Në letrën drejtuar presidenti Hashim Thaçi, Kurti ka shkruar se takimi do të ndodhë ditët në vijim, duke shtuar se po i shqyrton nenet që shefi i shtetit ia ka përmendur në dy ftesat e tij. "I nderuar presidenti i Republikës së Kosovës, ju faleminderit për dy ftesat e sotme që të takohemi sot, ftesa këto që fillimisht publikoheshin nëpër portale, pastaj mbërrinin në zyrën tonë. Sot isha jashtë vendit. Nuk do të mund të vij as sonte. Për t'u konsultuar për caktimin e mandatarit për formimin e qeverisë, takohemi gjatë ditëve në vijim. Ndërkohë, por i shqyrtoj këto nenet që i keni përmendur në dy letrat tuaja", ka shkruar Kurti në letrën drejtuar presidentit Thaçi.

Njohësi i proceseve politike në vend, Vigan Qorrolli, ka vlerë-

suar se caktimi i mandatarit për formimin e qeverisë ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në dinamikën e formimit të institucioneve, përkatësisht qeverisë, pasi që nga momenti i caktimit të tij do të nisë rrjedhja e afatit kushtetues prej 15 ditësh për formimin e qeverisë së re. "Teksti i ftesës së presidentit të Republikës drejtuar fituesit të zgjedhjeve, kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, për t'u takuar gjatë ditës së sotme, nuk është një tekst normativ i cili e mandaton me automatizem 'ipso jure' kandidatin për kryeministër të Kosovës. Afati kushtetues 15 ditor nuk fillon të rrjedhë sipas këtij dokumenti që është një akt pa titull të saktë shkresor, derisa ky afat kushtetues do të fillojë së efektuari juridikisht vetëm nga

momenti kur shefi i shtetit ia dorëzon dokumentin zyrtar: Dekretin për Nominim të kandidatit për Kryeministër", ka shkruar Qorrolli në profilin e tij në "Facebook".

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, si fitues i zgjedhjeve të 6 tetorit ende nuk ka arritur ta bëjë një marrëveshje për koalicion qeverisës me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Bisedimet në mes të këtyre dy subjekteve politike janë përkeqësuar të enjten, kur në seancën konstituive të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës LV-ja pa konsultim paraprak me LDK-në ka propozuar për kryetar të Kuvendit deputetin Glauk Konjufca, i cili edhe është zgjedhur me 75 vota për, 27 kundër dhe 6 abstenime.

## Meta nderon Pacollin me urdhrin e lartë 'Nënë Tereza'



**PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER)** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka nderuar me urdhrin e lartë "Nënë Tereza", ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, për ndjeshmërinë e treguar me rastin e tërmetit të 26 nëntorit. Pacolli ka thënë se ka qenë i prekur nga ceremonia që presidenti Meta ka organizuar për të. "Thellësisht i prekur nga ceremonia që presidenti i Shqipërisë, Meta, organizoi për dekorimin tim me urdhrin e lartë 'Nënë Tereza', me motiva-

cionin për ndjeshmërinë e lartë, personale dhe familjare, si gjithë populli dhe shteti i Kosovës, treguar përkundrejt popullatës së Thumanës dhe mbarë Shqipërisë, duke nxitur kështu një zinxhir solidariteti kombëtar të pashembullt me rastin e tërmetit të 26 nëntorit 2019 dhe për kontributin e vazhdueshëm humanitar në rrafsh kombëtar dhe global", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Pacolli ka treguar se çfarë i ka thënë Metës gjatë kësaj ceremonie. "I thashë

Presidentit dhe të ftuarve në këtë ceremoni, se kjo dekoratë i takon mbarë popullit të Kosovës, qytetarëve të saj, posaçërisht pensionistit që dhuroi pensionin e tij të vogël për vëllezërit e vet të Shqipërisë. I thashë, gjithashtu, se 'unë, vëllezërit e mi, fëmijët, bashkëshortja ime, familja ime jemi thjesht personifikimi i ndihmës dhe solidaritetit të gjysmës për gjysmën tonë kombëtare'. Bëra thirrje për pajtim mes vete, në Shqipëri, në Kosovë dhe midis Shqipërisë dhe Kosovës!", ka shkruar Pacolli.

Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

# Kosova është në krizë

Zëvendëskryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se vendi ka hyrë në krizë politike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo po ndodh për shkak se partnerët e koalicionit LV dhe LDK nuk kanë mirëbesim mes vete për ta formuar qeverinë e ardhshme. Hoxhaj ka thënë se u takon LV-së dhe LDK-së t'i formojnë institucionet pasi ato janë deklaruar publikisht para qytetarëve për një gjë të tillë. Ai ka thënë se në 20 vjetët e fundit Kosova është dëmtuar me qeveri me mandat afatshkurtër. Hoxhaj ka thënë se vendi nuk duhet të shkojë sërish në zgjedhje të reja. "Nuk mendoj se më 6 tetor qytetarët kanë dalë në zgjedhje për të mbajtur sërish zgjedhje të parakohshme. Qytetarët presin që të ketë institucione të reja dhe të mos blihet kohë", është shprehur Hoxhaj



**EPOKA E RE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 DHJETOR -

**"Epoka e re":** Z. Hoxhaj, pas zgjedhjeve të 6 tetorit dhe pas gati tre muajsh Kuvendi i Kosovës është konstituuar dhe tash po presim edhe formimin e qeverisë së re?

**Hoxhaj:** Të enjten është bërë një hap i rëndësishëm i konstituimit të Kuvendit të Kosovës, të zbatimit të Kushtetutës dhe marrjes së mandatit nga qytetarët nga ana e Kuvendit të Kosovës. Mendoj se politikisht vendi është në krizë meqë duket se nuk ka besim dhe vullnet mes partnerëve të cilët do të duhej ta formojnë koalicionin qeverisës dhe si të lëvizet përpara. Do të thotë, e kam përshtypjen se vendi është në një lloj krize politike.

**"Epoka e re":** Kuvendi është konstituuar dhe tash po shkojmë drejt formimit të qeverisë. Pse po thoni krizë politike?

**Hoxhaj:** Partnerët e koalicionit nuk janë afër që të merren vesh për përbërjen e qeverisë dhe po shohim hapat e njëanshëm të një subjekti politik dhe deklarime shumë kundërtënëse të një subjekti tjetër politik, gjë që tregon se është një situatë e paqartë dhe më e komplikuar sesa e kanë pritur qytetarët e Kosovës. Të dy partitë kanë deklaruar publikisht se do të bëjnë koalicion paszgjedhor dhe u takon këtyre dy partive që t'u tregojnë qytetarëve se cilat janë problemet për mosunitetin e tyre politik.

**"Epoka e re":** Si e komentoni refuzimin e Albin Kurtit për takim me presidentin Hashim

Thaçi pas dy ftesave që mori për t'u konsultuar për caktimin e mandatarit?

**Hoxhaj:** Nuk e di cili ka qenë komunikimi mes kandidatit për kryeministër dhe presidentit të vendit. Nuk e di se cilat janë situatat e brendshme politike te partitë politike, konkretisht te Lëvizja Vetëvendosje për shkuarje ose jo në takim. Por një gjë e di, se kanë kaluar më pak se 90 ditë pas 6 tetorit, ka kaluar një muaj pas certifikimit të rezultatit zgjedhor dhe është një paqartësi e madhe se si do të mund të duket qeveria e ardhshme sa i takon komunikimit edhe publik që kanë partnerët e koalicionit. Natyrisht se vetëm shumica parlamentare dhe presidenti mund t'i japin drejtim një agjende kohore se kur mund të formohet qeveria e ardhshme.

**"Epoka e re":** A besoni se do të formohet qeveria në mes të LV-së dhe të LDK-së duke i ditur raportet që kanë tashmë së fundmi?

**Hoxhaj:** U takon atyre që ta bëjnë qeverinë, por një gjë e di, se vullneti politik e tejkalon çdo pengesë dhe nuk mund të jetë një post apo ministri pengesë. Të dy partnerët duhet të kenë respekt reciprok me njëri-tjetrin. Ne si opozitë nuk duam të japim as këshilla dhe as t'ju shesim mend se si duhet ta bëjnë qeverinë e ardhshme. Pas shpalljes së zgjedhjeve qëndrimi i PDK-së ka qenë korrekt, se do të jemi opozitë. Kështu që ata duhet ta përm-bushin mandatin kushtetues.

**"Epoka e re":** Sa janë gjasat që vendi të shkojë sërish në zgjedhje të reja?

**Hoxhaj:** Nuk e di se cilët janë

skanarët që i kanë partnerët e koalicionit që duan t'i formojnë institucionet e ardhshme, por mund t'ju them se vendi është dëmtuar në 20 vjetët e fundit me qeveri afatshkurtra. Unë nuk mendoj se më 6 tetor qytetarët

kanë dalë në zgjedhje për të mbajtur sërish zgjedhje të parakohshme. Qytetarët presin që të ketë institucione të reja dhe të mos blihet kohë.

**"Epoka e re":** Në rast se vendi

shkon në zgjedhje, PDK-ja a është e gatshme?

**Hoxhaj:** Ne presim vendimet e atyre që pretendojnë se do ta formojnë qeverinë e ardhshme dhe mandej do të bëjmë një analizë se cilat janë interesat e

# politike

në temat e mëdha që e presin vendin siç është dialogu me Serbinë?

**Hoxhaj:** PDK-ja do të jetë një parti e cila do të ndjekë edhe një filozofi politike, një logjikë shtetërore për bërjen e opozitës. Se cilat mund të jenë qëndrimet tona për temat e caktuara dhe metodat politike është herët të thuhet. Ne nuk e dimë se si duket përbërja e qeverisë, ne nuk e dimë se cili do të jetë programi qeverisës dhe ne nuk e dimë se si do të sillet qeveria e ardhshme në raport me interesat shtetërore të vendit. Një gjë e di, se në një demokraci qeveris edhe ajo shumicë parlamentare e cila mund ta formojë qeverinë, por edhe opozita e ka pushtetin e saj. Pushteti i opozitës është beteja e ideve të reja dhe beteja e zgjidhjeve të reja. Ne si parti kemi përvojë më të gjatë duke qenë në qeveri dhe, po ashtu, kemi edhe një përvojë të mirë të opozitës 2004-2007.

**"Epoka e re":** A e keni pritur këtë rezultat të PDK-së më 6 tetor?

**Hoxhaj:** Jo, nuk e kemi pritur. Ne e kemi ditur që është një dallim jo i madh mes tri subjekteve të tjera politike. Kemi qenë të vendosur që ta japim maksimumin që t'i përfaqësojmë interesat e qytetarëve, veçanërisht të elektoratit të PDK-së. Mendoj se disponimi ka ndryshuar në dy-tre ditët e fundit dhe është bërë dallimi. Zgjedhjet që janë mbajtur më 6 tetor janë zgjedhje ku dallimi mes partisë së parë, të dytës dhe të tretës është 5-6 deputetë dhe nuk janë zgjedhje klasike të cilat i ka fituar PDK-ja në vitet 2010, 2014 dhe 2017, ku dallimi në votë mes partisë së parë dhe partive të tjera është i madh. Në këtë drejtim ne e kemi marrë seriozisht mesazhin e qytetarëve dhe kemi bërë analizat e brendshme dhe kemi marrë vendime politike të qarta se ne shkojmë në opozitë, por nuk e bllokujmë askënd sikurse në të kaluarën që kanë bërë të tjerët.

**"Epoka e re":** Z. Hoxhaj, PDK-ja e ka zgjedhur liderin, por jo edhe kryesinë e re. Kur do të ndodhë kjo?

**Hoxhaj:** Këto ditë do ta kemi një takim të Këshillit Drejtues. Besoj se këto ditë kryetari i partisë mund të dalë me propozime se si mund të duket Kryesia e ardhshme e Partisë Demokratike të Kosovës. Ne do të kemi debat permanent në atë se çfarë do të duhej të ndryshojë brenda PDK-së edhe në nivel qendror, por edhe në nivel të degëve dhe nëndegëve.

vendit dhe të PDK-së. Nuk ma merr mendja se duhet hyrë në skenarë që aktualisht janë imagjinarë.

**"Epoka e re":** Cili do të jetë roli i PDK-së në opozitë, veçanërisht



## FSK-ja vitin e parë si ushtri e përmbylli suksesshëm

Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, i shoqëruar edhe nga komandanti i FSK-së, Rahman Rama, ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka prezantuar aktivitetet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2019.

Berisha ka thënë se të gjitha objektivat e parapara për vitin 2019 janë realizuar me sukses. Ndërkaq komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rahman Rama, ka thënë se po përmbyllin vitin e parë si ushtri e vendit me suksese të mëdha në të gjitha fushat

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Në Ministrinë e Mbrojtjes të premten është mbajtur takim me gazetarë dhe përfaqësues të mediave, të cilët kanë përcjellë aktivitetet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës gjatë vitit 2019. Në takim ishin të pranishëm ministri Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rahman Rama dhe stafi civil i ministrisë dhe ushtarakë të FSK-së.

Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ka falënderuar mediat për informimin e qytetarëve dhe pasqyrimin e drejtë të aktiviteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të FSK-së gjatë vitit që po lëmë pas. Ai ka theksuar se kjo konferencë ka një rëndësi të veçantë, sepse në cilësinë e ministrit të Mbrojtjes po u drejtohet mediave në njëvjetorin e tranzicionit të FSK-së me mandat ushtarak. Berisha ka numëruar disa prej të arriturave kryesore gjatë këtij viti, ku përfshihen realizimi i plotë i objektivave të parapara gjatë vitit të parë të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së, avancimi i kapaciteteve operative, implementimi i strukturës së re

organizative të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së. Ai ka thënë se qytetarët kanë pasur rast t'i shohin njësitë e FSK-së sipas strukturës së re, me emblema dhe flamuj të rinj, gjatë rreshtimit në kuadrate në Ditën e Forcës më 27 nëntor.

Ministri i Mbrojtjes ka njoftuar gazetarët se gjatë kësaj periudhe njësitë të FSK-së u janë shtuar edhe 900 pjesëtarë të rinj. Ai ka thënë se me rekrutimet e fundit është rritur numri i pjesëtarëve të gjinisë femërore (11 për qind) dhe pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë (rreth 10 për qind) në strukturat e FSK-së.

Ministri iu referua edhe sondazhit të fundit rreth besueshmërisë së institucioneve të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2019. "Ky sondazh edhe këtë vit e ka nxjerrë FSK-në si institucionin më të besueshëm, me rritje në përqindjen e besueshmërisë krahasuar me vitin e kaluar. Është rritur edhe besueshmëria në FSK nga komuniteti serb në 12 për qind", ka thënë ai. Kjo, sipas ministrit Berisha, është falë punës së të gjithë ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve të FSK-së si dhe shërbyesve civilë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ministri Berisha ka ritheksuar se një nga objektivat strategjike të

Republikës së Kosovës është anëtarësimi në NATO. "Në këtë frymë, Republika e Kosovës ka raporte veçanërisht të mira me shtetet fqinje anëtare të NATO-s dhe ato që synojnë anëtarësimin në këtë organizatë", ka thënë ministri Berisha.

Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rahman Rama, ka thënë se po përmbyllin vitin e parë si ushtri e vendit me suksese të mëdha në të gjitha fushat. "Ne, falë bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe angazhimit të pjesëtarëve të FSK-së, i kemi përmbyllur të gjitha objektivat e planifikuara të FSK-së. Synimi ynë mbetet avancimi i ndërveprueshmërisë me forcat anëtare dhe partnere të NATO-s, si dhe pjesëmarrja jonë në operacionet paqeruajtëse të NATO-s, për ta dhënë kontributin e përgjithshëm për paqe, siguri dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë", ka thënë ai. Në fund, komandanti i FSK-së, duke i falënderuar gazetarët, ka thënë se transparenca e tyre dhe pasqyrimi profesional i mediave ka mundësuar që publiku dhe qytetarët e vendit në përgjithësi të informohen në mënyrë korrekte për FSK-në. "Kjo ka rezultuar me vlerësimin, për të tetin vit me radhë të FSK-së, si institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend", është shprehur Rama.

# Hyseni tregon të arriturat e 2019-s dhe sfidat që e presin KPK-në në 2020-n



PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, në konferencën e fundvitit për media, ka prezantuar të premtën veprimtarinë njëvjeçare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, rezultatet dhe sfidat me të cilat Këshilli është ballafaquar në realizim të mandatit të tij, si dhe planifikimin për vitin 2020. "Këshilli ka mbajtur këtë vit 16 takime si dhe ka nxjerrë rreth 215 vendime të cilat kanë shërbyer për realizimin e mandatit të tij ligjor dhe për shërbim të sistemit prokurorial. Për më tepër, Këshilli ka realizuar edhe takime të tjera të shumta përmes komisioneve të veta të përhershme, ad hoc dhe trupave të tjerë. Vlen të përmendet se në prill të këtij viti hyri në fuqi Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës ku me qëllim të zbatimit të këtij ligji Këshilli ka angazhuar me orar të plotë zëvendëskryesuesin e Këshillit, kryetarin e Komisionit për Çështje Normative, kryetarin e

Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe kryetarin e Komisionit për Administrimin e Prokurorëve", ka thënë Hyseni.

Ai ka përmendur disa prej sukseseve dhe punëve kryesore të realizuara nga Këshilli, bazuar në mandatin e vet kushtetues dhe ligjor. "Me qëllim të funksionalizimit dhe zbatimit të kompetencave dhe legjislacionit bazik, KPK-ja gjatë vitit 2019 ka hartuar dhe miratuar aktet nënligjore si Rregulloren për administrimin dhe ndarjen e lëndëve në Prokurorin e Shtetit, Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Publik në Sistemin Prokurorial, Rregulloren për procedurën e ndërmjetësimit për rastet penale nga prokuroria, Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve dhe Rregulloren për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës", ka bërë me dije Hyseni.

Ai ka treguar se Këshilli ka

miratuar edhe Planin strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021, ku janë përcaktuar objektivat trevjeçare të sistemit prokurorial. "Këshilli ka miratuar Strategjinë për Krime të Luftës si dhe ka themeluar mekanizmat e paraparë për implementimin e kësaj strategjie si: task-forca dhe grupi monitorues që në përbërjen e vet kanë përfaqësues të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Vlen të përmendet se ky dokument është me karakter nacional dhe ka mundësuar që Departamenti për Krime Luftë t'i trajtojë me prioritet rastet e kësaj natyre. E tëra kjo kornizë nënligjore dhe këto Strategji janë hartuar nga kapacitetet e sistemit prokurorial si dhe në bashkëpunim dhe me mbështetje të partnerëve tanë ndërkombëtarë", ka thënë Hyseni.

Ai ka theksuar se këto akte dhe strategji kanë ndikuar për ngritjen e efikasitetit dhe për përmirësimin e cilësisë së punës

përmes avancimit të sistemit të komunikimit publik, procedurave disiplinore ndaj prokurorëve, procedurave të emërimit të kryeprokurorëve, procedurave të ndërmjetësimit të rasteve penale si dhe administrimit dhe ndarjes së lëndëve. Ai ka shtuar se Këshilli gjatë vitit 2019 ka përfunduar procesin e rekrutimit të 12 prokurorëve të rinj të cilët në maj të vitit 2019 kanë filluar trajnimin fillestar njëvjeçar në Akademinë e Drejtësisë. "Me këtë proces, Këshilli ka rritur numrin e prokurorëve në 197, me ç'rast do të jetë numri më i lartë i prokurorëve që kemi pasur ndonjëherë, respektivisht 9 prokurorë për 100 mijë banorë, mesatare kjo e njëjtë me vendet evropiane. Vlen të theksohet se ky proces ka qenë transparent, meritore dhe është monitoruar nga shoqëria civile, OSBE-ja dhe përfaqësues të Projektit britanik 'Forcimi i sistemit gjyqësor në Kosovë'", ka thënë Hyseni.

Ai ka folur edhe për sfidat që e

kanë përcjellë gjatë këtij viti KPK-në. "Mosplotësimi i përbërjes së Këshillit me tre anëtarë joprokurorë, buxheti i pamjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha obligimet e krijuara, edhe pse kemi pasur rritje të buxhetit për këtë vit, mungesa e legjislacionit për rregullimin e ekspertizave, specializimi i prokurorëve për trajtimin e krimeve karakteristike (korrupsioni, krimi i organizuar, krimi ekonomik dhe krimet kibernetike), mosrespektimi i parimit të transparencës përmes disa publikimeve mediale që ndikojnë drejtpërdrejt në dëmtimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial, paqartësitë lidhur me implementimin e Ligjit për zyrtarë publikë dhe Ligjit për pagat, infrastruktura fizike (zgjerimi i hapësirave për Këshillin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, që gjendet në objekt me qira) dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit prokurorial", ka thënë Hyseni.

## Përfaqësuesit e MAPL-së organizojnë aksion për dhurim vullnetar të gjakut

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të


Pushtetit Lokal, të udhëhequr nga ministrja Adrijana Hoxhiq, të premtën kanë organizuar një aksion vullnetar të dhurimit të gjakut. Dhurimi vullnetar i

gjakut organizohet në MAPL-ja për disa vjet me radhë. "Nuk është e vështirë të japësh gjak, nuk është i dhimbshëm dhe është plotësisht i sigurt.

Posaçërisht, është ndjenjë e bukur nëse e dini që gjaku juaj mund ta shpëtojë jetën e dikujt ose ta ndihmojë atë të shërohet", ka thënë ministrja Hoxhiq.



# Situata reale në Kosovë dhe miopia politike e Ramës



Nga Bedri ISLAMI

"Minishengeni" i Ramës, të cilin as ai vetë ende nuk e di se çfarë është dhe ku do të shkojë, ka zgjuar aq shumë pasione, britma, dalldi nacionaliste, rrahje gjoksi dhe rrëmujë sa që vetëm shefi i qeverisë mund ta kishte llogaritur.

Si kurrë më parë, në gjithë këtë zallamahi u përfshinë strukturat e Kosovës, që nga Akademia e Shkencave, media të ndryshme që kurrë nuk kanë pasur një qasje pozitive ndaj Shqipërisë, aq më tepër kur në pushtet ka qenë e majta; figura interesante dhe të dalë nga hiçi, politikanë të klasës të parë dhe shefi i qeverisë, Haradinaj; u rithirrën në ndihmë fjalët e njohura, "tradhti", "tradhtar", u bënë gjithfarë thirrjesh, u ngritën hipoteza, gjithçka u duk sikur, jo larg, por të nesërmen e një samiti budalla, Kosova do të shitej, ajo do të copëtohej, Serbia do të ishte përsëri në Kosovë etj.

Së pari, as Edi Rama, as Haradinaj, as Thaçi e as Kurti nuk kanë as tagër e as nuk mundën të prekin një pëllëmbë Kosovë. Edhe sikur të ketë një qeveritar në Kosovë apo në Shqipëri që do të synonte shitjen e saj, kjo gjë ka marrë fund një herë e mirë, që nga qershori i vitit 1999. Ai që nuk e di, ka

gjithë kohën e duhur për ta mësuar e për të mos e harruar. Kosova, aq sa është meritë e lëvizjes çlirimtare dhe e mendimit politik racional, aq është, në mos më tepër meritë e Shteteve të Bashkuara dhe Evropës. Kufijtë e saj, një ditë, ndoshta do të mund të zgjerohen, por kurrësi të rrudhen. Prova e bërë në definimin e kufirit me Malin e Zi tregoi se vetëm një grupim i mbledhur rreth fuqive të mëdha mund të bëjnë gjëma të tilla, por njerëz të veçantë nuk e kanë atë tagër e as atë forcë.

Këtë e dinë politikanët e Kosovës, disa nga të cilët kanë qenë ministra apo të përkëdhelur në regjimin e Millosheviqit, e dinë medialë që kanë marrë fonde e vazhdojnë të marrin fonde nga anale serbe; e dinë tregtarë që e kanë mbushur Kosovën me mallrat serbe; e dinë qeveritarë që janë me gjysmën e kokës të kthyer nga Beogradi, e dinë akademikë, që, jo shumë kohë më parë kanë qenë anëtarë të Lidhjes Komuniste të Kosovës, një aneks i Lidhjes Komuniste të Serbisë, apo edhe bashkëpunëtorë të shërbimit të fshehtë serb.

Kam dëgjuar thirrje nga intelektualë që 20 vite më parë malikonin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, nga gazetarë mistrecë që shkruanin me ironi për këtë, sa që deklarorin, kur vriteshin heronjtë e ardhshëm të saj se "UÇK-ja po përvetëson viktimat e dhunës serbe", ashtu si kam ndjerë shqetësimin e natyreshëm të disa njerëzve, statura e të cilëve të ngjall besim e

shpresë.

Kosova, politika, media dhe mistrecët e saj iu futën luftës kundër "minishengenit" dhe Ramës, me një turr të tillë që asnjëherë nuk i janë vërsulur hordhive serbe nga të gjitha anët; ata që, në vitin 1998 ngritën grupe pune e komisione të veçanta për të hetuar "krimet" e luftës së UÇK-së, por kurrë të krimeve serbe mbi Kosovën.

Nëse politika serbe dhe njerëzit e saj në Kosovë kanë pasur dhjetëra qëllime, njërin prej tyre e kanë arritur që tani: me "ndihmën" e miopisë politike të Ramës dhe duke vënë në lëvizje falangat e tyre në lobin serb, që nuk vegjeton në Prishtinë dhe Tiranë, ata kanë bërë një ndarje të hatashme, të dhimbshme dhe kanë ngritur një stuhi, e cila, nuk po ngihet rastësisht.

Në Kosovë, me 6 tetor janë bërë zgjedhjet parlamentare dhe po bëhen tre muaj që nga ajo ditë, e cila u shpall si mësim, por që nuk paska qenë asgjë tjetër, veçse vazhdimi i mentalitetit shqiptar mbi politikën.

Në tre muaj, ndërsa i vërsulen me të gjithë kthetrat Edi Ramës, nuk kanë arritur të bëjnë më të domosdoshmen, qeverinë e re, dalë nga këto zgjedhje.

Kosova është në gjysmë zëri; shefi i qeverisë është në largim, dhe, megjithëse nuk besoj se Gjykata Speciale do të ketë të papritura për të, përsëri ai është në pritje të qeverisë së re. Qeveria ka rënë prej afër një gjysmë viti dhe korrupsioni po gërryen shtetin deri në thelb. Dy partitë kryesore po kapen prej zhelesh politike, duke arnuar

programet, sipas një parimi të pakuptimtë: të jap 50 për qind të programit tim, më jep 50 për qind të programit tim; të jap dy ministra dhe më jep presidentin; të jap kryetarin e parlamentit dhe më jep dy nënkryetarë. Posti i presidentit të ardhshëm është vënë në tryezë si një kurban; kush do e marrë dhe kush do e lërë. Rinumërimi i votave tregoi se tek të gjithë liderët kryesorë ata ishin shtuar, nganjëherë paradoksalisht, duke dëshmuar se sistemi i listave të hapura nuk është asgjë tjetër, veçse dhunimi i votës dhe dalja e të fortëve. Askush nuk e dënoi këtë rritje artificiale të votave... të gjithë po sulen drejt ndarjes së posteve.

Për ta krijuar qeverinë e re të Kosovës, sidomos tani kur dy liderët kryesorë e kanë më të lehtë të flasin përmes 'fb'-ve sesa me njëri-tjetrin, nuk u ka faj as Edi Rama, as qeveria e së majtës dhe tërmeti, për përbalimin e pasojave të para u shquat.

Partitë politike në Kosovë e kanë më të lehtë të sulmojnë Edi Ramën, të kërkojnë kthimin e përparësive nga ta duan e si ta duan, se sa të formojnë qeverinë e re, nga e cila shumë presin e jo shumë besojnë. Një përzierje e verës së paprovuar me uthullën e stërprovuar nuk ka shenja të dobishme për të ardhmen dhe, si do që të jetë, Albin Kurti do të ketë ballë vetes një detyrë më të vështirë, shumë më të vështirë, se sa dhjetëra e dhjetëra protesta, manifestime dhe përleshje që ka bërë.

Koha e provës së tij nuk varet nga halucinacionet e Edi Ramës

dhe as nga dalldia nacionaliste, që herë pas here, në vite të shkuara, njerëz pranë tij e kanë ndezur.

Albin Kurti është lideri më i votuar në Kosovë, por nuk ka ndodhur asnjë mrekulli. Me 240 mijë votat ndaj tij nuk mund të bëhesh paternalist, as ndaj forcave të tjera politike në Kosovë, e as ndaj shtetit shqiptar, i cili, edhe kur Edi Rama ia fut kot, si në këtë rast, ka forcë të zgjohet nga ajo që e ka në thelbin e tij, vetëdijen kombëtare.

E lehtë është të merresh me shtetin shqiptar, shefin e qeverisë, që nuk po bën më shumë sesa kanë bërë pararendësit e tij dhe se sa mund të bëjnë pasrendësit e tij, nëse ndonjë herë vijnë në pushtet. Ai nuk ka bërë më shumë se sa liderët e djeshëm të Kosovës e dhëntë Zoti të mos e bëjnë edhe liderët e rinj.

Në politikë, ndryshe nga sa ndodh në luftë, gjithçka fillon nga pragu i shtëpisë, pra nga vetja. Të mos shikosh veten, duke ia ngulur sytë tjetrit, në fund të fundit, rëndimi do të jetë i yti.

Qeveria e Kosovës duhet të ngrihet sa më parë, në mënyrë që edhe qëndrimet e saj, zyrtare, të një lidhshipi të ri, të merren seriozisht, të kenë epërsinë e tyre dhe të jenë më shumë të studiuara se sa britmat në dhomat e befta të nacionalizmit.

Dhe, kur këto të fundit bëhen nga një sërë mediale e politike, akademike e rrugore, nga ata që u puthnin gjithë qejf dje e flirtojnë gjithë afsh sot, atëherë e gjithë kjo të ngjall krupën.

## Prokuroria e Prizrenit gjatë këtij viti ka trajtuar 227 raste të dhunës në familje

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRIZREN, 27 DHJETOR - Në Prokurorinë Themelore në Prizren është mbajtur takimi i tretë përmbyllës për këtë vit i grupit koordinues me përgjegjësit të cilët merren me trajtimin e rasteve dhe veprave penale të dhunës në familje, brenda kompetencës së kësaj prokurorie, duke vepruar sipas procedurave standarde të veprimit.

Në këtë takim, të thirrur dhe organizuar nga prokurorja dhe koordinatorja për rastet e dhunës në familje, Mehreme Hoxha, në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prizren, ishin të pranishëm zëvendëskrye-

prokurorja e Shtetit, Sevdije Morina, njëherësh koordinatore për rastet e dhunës në familje në kuadër të Prokurorit të Shtetit, përfaqësues nga Ambasada Amerikane, përfaqësues nga Policia e Kosovës për rajonin e Prizrenit, mbrojtës të viktimave, përfaqësues nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale, Strehimorja si dhe zyrtarë nga Shërbimi Sprovues.

Të gjithë pjesëmarrësit në takim vlerësuan lart bashkëpunimin që ekziston në mes të institucioneve kompetente për trajtimin efikas dhe të shpejtë të këtyre rasteve dhe u potencua se rastet e dhunës në familje janë rastet më të vështira për trajtim, pasi që në shumë raste si të dëmtuara



paraqiten viktimat e ndjeshme. Po ashtu, u theksua se përkundër sfidave dhe vështirësive, të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me

dhunën në familje janë kryer me prioritet.

Kështu, në Prokurorinë Themelore në Prizren vetëm

gjatë këtij viti janë kryer gjithsej 227 lëndë të cilësuar si dhunë në familje, ndërsa aktualisht në punë janë 15 lëndë. Si rezultat i diskutimeve, me qëllim të trajtimit sa më efikas të këtyre rasteve, në fund të takimit nga pjesëmarrësit u nxorën rekomandimet që në të ardhmen të përmirësohen kallëzimet penale lidhur me rastet e dhunës në familje, në veçanti të bëhet vlerësimi i rrezikshmërisë të viktimave, pastaj u rekomandua që përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale çdo herë të jenë të pranishëm kur kemi të bëjmë me viktimat të ndjeshme si dhe u kërkua që të bëhet fuqizimi i strehimoreve përmes përkrahjes financiare nga institucionet relevante shtetërore.

# Bashkimi problematik i ministrive

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Reduktimi i ministrive të Qeverisë së Kosovës, nga 21 sa kanë qenë deri më tash, në 12, siç kanë paralajmëruar partitë që synojnë formimin e koalicionit qeverisës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, sipas organizatave joqeveritare, "Demokraci Plus" dhe "Çohu", do t'i ketë anët pozitive, por mund të përcillet edhe me probleme, të cilat do të ndikojnë edhe në performancën e qeverisë së ardhshme. Sipas tyre, reduktimi i numrit të ministrive do të jetë i kushtëzuar me bashkimin e disa ministrive ekzistuese dhe kjo mund të ndikojë në agjendat e ministrive përkatëse të cilat janë në zbatim e sipër.

Visar Rushtiti nga "Demokraci Plus" thotë për "Radion Evropa e Lirë" që tashmë ekzistojnë paralajmërimet se Ministria e Integritimit Evropian do të bashkohet me Ministrinë e Punëve të Jashtme, si dhe Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të bashkohen me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Bashkimi i këtyre ministrive, sipas tij, mund të ndikojë në agjendat përkatëse. "Agjenda e integritimit evropian mund të ndikohet për shkak të organizimit të Ministrisë së Integritimit Evropian, ashtu siç është propozuar, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme. E dyta është reforma e adminis-

tratës publike, e cila, po ashtu, mund të ndikohet nëse, siç është propozuar, Ministria e Administratës Publike bëhet bashku me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme", ka pohuar Rushiti. Ai ka shtuar se opsioni më real do të ishte që organizimi i integritimit evropian të bëhej në kuadër të një agjencie apo sekretariate në kuadër të zyrës së kryeministrit. Sipas tij, edhe reforma e administratës publike do të ndikohet në qoftë se Ministria e Administratës Publike bëhet pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht, siç thotë ai, Ministria e Administratës Publike duhet të mbetet e vetme sikurse që ka qenë deri më tash. Mendim të përafërt ka edhe Artan Demhasaj nga Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet - Çohu. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai vlerëson që fuzionimi i ministrive mund të shkaktojë telashe të mëdha për qeverinë e ardhshme. "Bashkimi i këtyre ministrive ka për t'u shkaktuar shumë telashe, sidomos kur po synojnë t'i bashkojnë disa ministri si, për shembull, (Ministrinë e Administrimit) të Pushtetit Lokal me atë (Ministrinë) e Punëve të Brendshme, që nuk kanë kurrfarë lidhshmërie në mes vete. Do të ketë telashe edhe me agjendë, për përcaktim të agjendës dhe te ligjet. Kur të fillojnë t'i ndryshojnë



ose t'i hartojnë ligjet e reja, do të kenë shumë telashe", ka theksuar Demhasaj.

Megjithatë, reduktimi i numrit të ministrive, sipas Rushtit, është shprehur si domosdo nga shoqëria civile që moti. Reduktimi i paralajmëruar, siç thotë ai, në 12 ministri do të shkaktojë telashe me akomodimin e zyrtarëve që punojnë në ministrinë aktuale. "Mirëpo, ky nuk është proces i cili mund të bëhet për një apo dy muaj. Ne kemi thënë që qeveria

duhet ta kërkojë votën në Kuvend, me 12 ministri. Të zgjedhë 12 ministri sipas fushave. Duhet zgjedhur fushat të cilat duhet të jenë në kuadër të këtyre 12 ministrive dhe pastaj, këto nëntë ministrinë e tjera duhet të akomodohen dhe organizohen si pjesë e këtyre 12 të parave në mënyrë graduale. Ndoshta i tjeri një mandat imi katërvjeçar kalon derisa të bëhet një sistematizim i plotë dhe i mirëfilltë i të gjithë atyre, që mund të themi kushtëzimisht, janë

tepricë në këto nëntë ministrinë e tjera", u shpreh Rushiti.

Por, Demhasaj thotë se problemi me të cilin do të ballafaqohet qeveria e ardhshme, në rast se i reduktim ministrinë sipas paralajmërimeve, do të jetë delegimi apo akomodimi i nëpunësve që kanë kontrata me qeverinë. Në rast se ata largohen nga puna, sipas tij, mund ta padisin në gjykata qeverinë dhe kjo mund të sjellë pasoja financiare për këtë të fundit. "Nuk nënkupton vetëm ajo që e bashkëve ministrinë dhe një ministër, por më vonë janë telasht që vijnë te stafi. Tash, t'i largosh ata nga puna, nuk është zgjidhje, sepse ata kanë kontrata dhe e padisin qeverinë dhe mund ta fitojnë rastin në gjykatë, për shkak se u është bërë e padrejtë atyre. Fillimisht është problem edhe që fizikisht t'i bashkohet (ministrinë), sepse një pjesë të stafit e ke diku dhe një pjesë të stafit diku tjetër. Kontrolli nuk mund të jetë i përditshëm nga ana e sekretariatit ose sekretariatit në përgjithësi. Kjo më pas mund të shkaktojë telashe dhe performanca mund të jetë e dobët, sidomos në fillim, derisa të rregullohet se si kanë për të funksionuar këto ministri", vlerësoi Demhasaj. Ai shtoi se reduktimi i administratës publike nënkupton edhe reduktimin e stafit. Kosova në vazhdimësi ka pasur vërejtje nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe nga Raporti i Progresit për Kosovën, që administrata publike është e ngarkuar tej mase.

## Shoqata e Naftës bën thirrje për krijimin e institucioneve vendore



PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Shoqata e Naftarëve ka mbajtur takimim e fundit për këtë vit, në të cilin ka analizuar ecurinë e sektorit gjatë këtij viti.

Kryetari i Shoqatës së Naftarëve, Fadil Berjani, ka falënderuar të pranishmit për kontributin e dhënë në mbështetje të shoqatës, në veçanti guximin e tyre për ta avancuar dialogun publiko-privat në interes të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ai ka deklaruar se ky vit karakterizohet me sfida të shumta, në veçanti me mungesën e stabilitetit

ekonomik si pasojë e zgjedhjeve të këtij viti pasi, sipas tij, kur ka mungesë të stabilitetit ekonomik paraqiten dukuri negative të cilat e dëmtojnë ambientin e të bërit biznes, në veçanti e dëmtojnë konkurrencën e lirë. "E veçanta e këtij takimi ka qenë apeli i shoqatës drejtuar partive fituese të zgjedhjeve të tetorit që me ngut të themelohen institucionet e shtetit në qoftë se mendohet në zhvillim ekonomik dhe mirëqenie të gjithë qytetarëve të Kosovës", thuhet në komunikatën e Shoqatës së Naftarëve.

## Filluan punimet për renovimin e zyrave të AKP-së

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Të premtën është realizuar vizitë e përbashkët pune në objektin e ish-ndërtësës "Rilindja" në mes të Ministrisë së Administratës Publike (MAP) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me fillimin e punimeve për renovimin e një pjese të hapësirës së ish-ndërtësës "Rilindja" për

nevoja administrative për zyra për zyrtarët e AKP-së. Në vizitë ishte ministri i Ministrisë së Administratës Publike (MAP), Mahir Jaghillar, me bashkëpunëtorë, drejtori i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Valon Tolaj, me bashkëpunëtorë, me ç'rast inspektuan fillimin e punimeve.

Këto objekte do ta akomodojnë stafin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit nga Zyra Qendrore dhe Zyra Rajonale e AKP-së në Prishtinë, gjithashtu këto objekte do të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për arkivimin e të gjitha dokumenteve administrative të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim.





# Telekomi i Kosovës: Ministri Lluka rrezikon sigurinë nacionale

Telekomi i Kosovës ka vlerësuar se vendimi i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, për mosekzekutim të vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve për implementim të kodit shtetëror dhe Ligjit për përgjime ligjore, është në disfavor të kësaj kompanie

## "Epoka e re"

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Telekomi i Kosovës përmes një komunikate për media ka reaguar ndaj vendimit të fundit të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, për mosekzekutim të vendimit të Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve për implementim të kodit shtetëror dhe Ligjit për përgjime ligjore. "Viti 2019 Telekomit e Kosovës e ka karakterizuar me sfida dhe vështirësi të shumta qoftë në

aspektin e operimeve si rezultat i pamundësisë financiare për t'i mirëmbajtur dhe zhvilluar platformat e veta për ofrimin e shërbimeve më të mira për konsumatorët; qoftë nga mungesa e përkrahjes së munguar nga Aksionari, konkretisht nga MZHE, si përfaqësues i Qeverisë së Kosovës. Është e kuptueshme se të gjitha kompanitë telekomunikuese në botë vitet e fundit janë ballafaquar me rënie të të hyrave si pasojë e shumë faktorëve, ndërsa kësaj rënie nuk i ka shpëtuar as Telekomit i

Kosovës. Duke marrë parasysh këtë trend, Telekomit i Kosovës, problemet, sfidat, telashet financiare i ka adresuar në mënyrë zyrtare vazhdimisht te ministri i MZHE-së, z. Valdrin Lluka", është thënë në reagimin e Telekomit.

Sipas këtij reagimi, ministrit Lluka çdoherë dhe në çdo takim të mundshëm i janë rikujtuar problemet dhe pasojat e mundshme nga neglizhenca dhe mospërkrahja e duhur për Telekomit, në kohën kur ka pasur nevojë më së shumti për bashkëpunim reciprok dhe adresim të qartë të vendimarrjeve në dobi të stabilitetit teknik, financiar dhe social për Telekomit e Kosovës. "Në vend të kësaj përkrahje të munguar, ministri Lluka, për arsye që vetëm ai i di, në shumë raste e ka dëmtuar imazhin e Telekomit të Kosovës me deklaratat e tij për falimentim të ndërmarrjes,

deklarime këto që nuk do të duhej ta përfaqësonin qëndrimin parimor dhe logjik të aksionarit, në këtë rast të Qeverisë së Kosovës. Prapavija e deklarimeve të tilla nga ministri Lluka edhe sot mbetet e panjohur dhe e pasqaruar. Dhe, në të njëjtin kohë, vendimi për mosekzekutim të mjeteve të ndara nga Qeveria e Kosovës, ministri Lluka e forcon edhe më tepër bindjen tonë se me vendimet e tij po e dëmton qëllimshëm dhe për interesa të veta afarizmin e Telekomit të Kosovës".

"Deklarimet e ministrit Lluka për qëllimet e tij tendencioze jo vetëm që kanë stagnuar operimet normale të kompanisë sonë, por me veprimet e tilla po rrezikon edhe Sigurinë Nacionale duke vështirësuar operimin e institucioneve të sigurisë kombëtare, siç janë Policia e Kosovës, AKI, KFOR-i, Shërbimi i Zjarrfikësve, Shërbimi i

Emergjencës, Kulla e Aeroportit. Ne gjatë gjithë kësaj kohe kemi kërkuar përkrahje nga ky ministër për të na mundësuar dhe lehtësuar procedurat e finalizimit të procesit të marrjes së një garancie bankare për t'i financuar projektet më të rëndësishme për Telekomit e Kosovës, siç janë projekti për implementimin e Kodit Shtetëror, Ligji për Përgjime si dhe mirëmbajtja e tërësishme e platformave teknike. Megjithatë, të gjitha këto sfida dhe vështirësi i kemi përballuar dhe tejkaluar me angazhim të përbashkët. Telekomit i Kosovës ka përcaktuar synimet dhe objektivat e qarta për vitin e ardhshëm dhe besojmë se do të arrijmë t'i jetësojmë me përkushtimin e paçmueshëm të të gjithëve, duke përfshirë mbështetjen e nevojshme institucionale", është thënë në reagimin e Telekomit të Kosovës.



## "Sowi Kosovo" planifikon të investojë 169 milionë euro në Mitrovicë

MITROVICË, 27 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në një takim përfaqësuesin nga kompania "Sowi Kosovo" LL. C, Ilir Grapci, me të cilin ka nënshkruar një aneks-memorandum mirëkuptimi mes të dyja palëve. Qëllimi i këtij memorandum është leji-

mi i investitorit "Sowi Kosovo" për qasje mbi parcelat e ndërmarrjes, për zgjerimin e rrugës së nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës përcjellëse me pëlqimin e Komunës së Mitrovicës, përkatësisht të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka ofruar

mbështetjen e tij të plotë ndaj investitorit, për të ndihmuar në procedurat ligjore që kanë të bëjnë në Komunën e Mitrovicës, duke thënë se çdoherë është i gatshëm për t'i mbështetur investitorët për realizimin e projekteve të ndryshme në qytetin e Mitrovicës.

Në kuadër të këtij projekti në qytetin e Mitrovicës do të ndërtohet parku energjetik ku do të prodhohen 105 MW energji elektrike përmes 30 turbinave me erë.

Ky investim nga kompania "Sowi Kosovo LLC" planifikohet të bëhet në shifrën prej 169 milionë eurosh dhe do të jetë më i



madhi i bërë që nga pas lufta në fushën e investimeve në energji alternative.

## Kastrati takon komunitetin e bizneseve dhe organizatat joqeveritare

KAMENICË, 27 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me drejtoreshën për Zhvillim dhe Diasporë, Majlinda Krasniqi, kanë mbajtur takim me komunitetin e bizneseve dhe organizatat joqeveritare për të shënuar një vit me të arritura. Në këtë takim Kastrati, duke falënderuar përfaqësuesit e bizneseve dhe OJQ-të për bashkëpunimin me Komunën e Kamenicës, ka folur për projektet e përbashkëta dhe sfidat që kanë kaluar gjatë këtij viti. Ndër të tjera, ai ka falënderuar institucionin mikrofinanciar "KEP" për

mbështetjen e këtij aktiviteti. Në anën tjetër, përfaqësuesit e bizneseve dhe të organizatave joqeveritare në Kamenicë kanë falënderuar kryetarin Kastrati për punën që ka bërë lidhur me lehtësimin e procedurave për bizneset dhe OJQ-të. Më tutje, ata kanë treguar vërejtjet e tyre si dhe kërkesat që kanë në drejtim të Komunës së Kamenicës. Në fund të takimit është arritur pajtueshmëri që të shtohet bashkëpunimi për vitin e ardhshëm me qëllim të përmirësimit të ambientit të biznesit në vend si dhe kontributin në komunitet.



## 120 blegtorë prizrenas përfitojnë makina për mjeljen e lopëve

PRIZREN, 27 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Egzon Elshani, të premtën kanë bërë shpërndarjen e makinave mjelëse për lopë qumështore, të cilat u janë dhënë blegtorëve

përfitues nga thirrja publike e kësaj drejtorie. Nëpërmjet këtij projekti përfitues janë shpallur 120 blegtorë, të cilët i kanë plotësuar kriteret dhe kushtet e përcaktuara nga thirrja publike. Vlera totale e këtij projekti ka qenë 21 mijë e 478 euro, me participim të plotë nga ana e

Komunës së Prizrenit. Kjo është hera e tretë për sivjet që Komuna e Prizrenit ndanë subvencione për blegtorët që merren me prodhimin e qumështit ngaqë më parë është bërë subvencionimi i tyre edhe me lopë qumështore dhe ngritje të stallave.

## Bashkatdhetari Qazim Hoti ndihmon 25 familje në prag të festës së Vitit të Ri



MALISHEVË, 27 DHJETOR (ER) - Bashkatdhetari dhe humanisti nga Carralluka e Malishevës, Qazim Hoti, sikurse në çdo festë, edhe kësaj radhe në prag të ndërrimit të moteve ka dhuruar 2 500 euro përkrahje për 25 familje në nevojë në Komunën e Malishevës. Mërgimtari Hoti në vazhdimësi në të gjitha festat fetare apo në ato të fundvitit ndihmon familjet në nevojë dhe këtë ndihmë e përcjellë përmes institucionit të komunës, përkatësisht Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Për këtë qëllim, nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, e ka pritur në takim mërgimtarin Qazim Hoti, të cilin e ka falënderuar për këtë ndihmë. "Në emër të Komunës së Malishevës ju falënderoj për këtë

ndihmë dhe ndihmat e tjera që ju në vazhdimësi i keni dhënë për familjet në nevojë. Po ashtu, ju siguroj se mjetet e juaja do të shkojnë në familjet që më së shumti kanë nevojë dhe të cilat janë në listën e familjeve me gjendje të rëndë sociale në drejtorinë përkatëse", ka thënë Berisha. Ndërsa mërgimtari dhe humanisti Qazim Hoti ka thënë se është i sigurt se këto ndihma do të shkojnë në familjet që kanë nevojë. "Unë jam nga ky vend, kjo është vendlindja ime dhe këta njerëz janë të vendit tim. Unë e kam mundësinë që nga buxheti familjar t'i ndihmoj në raste të caktuara njerëzit në nevojë dhe dëshiroj që fëmijët e këtyre familjeve të ndihen të barabartë me të gjithë fëmijët e tjerë në prag të festës së Vitit të Ri", ka thënë Hoti.

## Elezaj premtion përkrahje për Qendrën e Punës Sociale në Klinë

KLINË, 27 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga drejtori i Shëndetësisë, Hekuran Sejdiu, dhe ai i Administratës, Binak Sylja, kanë vizituar Qendrën për Punë Sociale në Klinë, ku janë pritur nga drejtori i kësaj qendre, Ilir Bacaj. Drejtori Bacaj ka falënderuar kryetarin Elezaj për vizitën e realizuar dhe për mbështetjen dhënë këtij institu-

cioni për krijimin e kushteve të favorshme të punës. Po ashtu, Bacaj ka njoftuar kryetarin Elezaj për aktivitetet e realizuara dhe angazhimet gjatë vitit 2019 dhe për sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion gjatë ofrimit të shërbimeve për familjet në nevojë. Ndërsa kryetari Elezaj, duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm rolin që ka ky institucion

për familjet dhe personat në nevojë për përmirësimin e kushteve të tyre, ka premtuar se edhe gjatë vitit 2020 do ta mbështesë Qendrën për Punë Sociale nëpërmjet projekteve të ndryshme, me qëllim që të krijohen mundësi për përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga ky institucion dhe të shtohet përkujdesja ndaj personave në nevojë.



# Migrantët dhe Evropa



Shkruan: Mentor TAHIRI

Nuk ka një definicion shumë të qartë se çfarë do të thotë migrant. E drejta ndërkombëtare është e turbullt në këtë drejtim. Janë fjalorët gjuhësorë dhe praktikat ato që rrumbullakojnë termin. Pavarësisht kësaj, migrimi dhe njerëzit që migrojnë janë pasqyrë e situatave historike e të tanishme në shumë rrafshë. Në Evropën e viteve të fundit, ajo që quajmë "kriza të migrantëve", e ka bërë migrantin më të njohur. Kontinenti i vjetër, nuk është sot pjesa më e zhvilluar e planetit, por në raport me Amerikën Veriore apo shtete të bumit industrial si Japonia, Evropa është më e arritshme për njerëz që vijnë nga dy kontinentet ngjitur me të, e të cilët kërkojnë më shumë shpresë. Në "krizën e migrantëve" deri tani janë identifikuar kryesisht dy "dyer" të mëdha me anë të cilave migrantët tentojnë të hyjnë në

kontinent. E para është e ashtuquajtura rrugë e Mesdheut perëndimor dhe qendror, ku njerëz nga shtetet e Magrebit, Sahellit dhe përtej tij, kërkojnë shpresë përmes rrugës së vështirë nëpër Sahara, ku pastaj përmes brigjeve veriperëndimore të Afrikës, përpiqen të arrijnë brigjet e Spanjës apo të Italisë. Përvojat e hidhura të "fatit" njerëzor flasin se ky rrugëtim ndërmjet jetës dhe vdekjes zgjatë deri në 3 vite.

Dera e dytë është ajo lindore, kryesisht vija Turqi - Evropë Juglindore si rrugë tokësore, kurse gjithnjë më pak ajo e Mesdheut lindor si rrugë detare. Konfliktet shkatërruese në një varg shtetesh, luftërat civile sfiltesë, jeta e pabarabartë në regjime diktatoriale dhe një serë faktorësh tjerë politikë, ekonomikë dhe socialë kanë rrënuar shpresën e njerëzve që nga Afganistani e deri në Mesdhe.

Sipas një statistike e cila ndryshon varësisht nga burimet, por ku burimet në vija të trasha përputhen, gati 20 për qind e njerëzve të cilët gjatë vitit 2019 në Evropë po trokasën përmes "derës" ballkanike janë nga Afganistani, kurse sirianët janë në vendin e dytë me 15 për qind. Ky raport ka ndryshuar ndër vite, sirianët përbënin më shumë së

gjysmën e migrantëve në vitet 2015 dhe 2016, vite këto kur faktikisht shuhen shpresat se regjimi i Assad mund të rrëzohet, e ku kyç ishte involvimi ushtarak rus në luftën civile.

Është e dhimbshme që fatkeqësia e njerëzve të konvertohet në statistikë, por pa të përmasat e tragjedisë që ka kapluar dikë nuk mund të kuptohen. Në raport me njerëzit e ikur, Turqia po bartë koston më të madhe të konflikteve në Lindjen e Mesme, kryesisht atij në Siri.

Gati 4 milionë refugjatë e që përbën numrin më të madh të refugjatëve në botë, kanë gjetur strehim atje. Mbase opinioni publik evropian as nuk ka arritur kurrë të kuptojë përmasat e vërteta të tragjedisë njerëzore në Lindjen e Mesme, pikërisht për faktin se "kontingjenti" shumëmilionësh i njerëzve të strehuar në Turqi, ka mësyre Evropën vetëm në numra shpërfillës në raport me numrin e përgjithshëm. Deri tani viti më kritik i "korridorit" Turqi - Evropë Juglindore ishte 2015-ta kur kaluan gati 800 mijë migrantë.

Kur flitet për valët e migrantëve që janë përplasur në Evropë viteve të fundit, janë disa shqetësime që ngritën. Disa shqetësime vijnë nga elementet e racizmit në diskursin publik, të cilët janë

gjithsesi të frikshëm se nuk përkojnë me vlerat e promovuara të demokracive të pjekura evropiane. Fillimisht kishte përpjekje që vala e migrantëve të bllokohet në Ballkan. Disa qeveri sikurse ato të vendeve post-komuniste, fare të pavetëdijshme se nuk janë atraktive për njerëzit që kërkojnë një jetë më të mirë, valën e migrantëve e shihnin si një agresion nga i cili duhet mbrojtur.

Popullistët e shfrytëzuan "rrezikun" nga "sirianët" si impuls për mobilizimin e elektoratit. Në disa vende, ilegalisht në raport me ligjin por me elemente të dukshme të një aprovimi të heshtur publik, u organizuan edhe grupe civilësh të cilët mbrojnë kufirin nga migrantët. Megjithatë, trendët kanë treguar vazhdimisht se migrantët kanë synuar gjithmonë shpëtimin në vendet e zhvilluara dhe të industrializuara të Evropës, aty ku ka edhe vende pune.

Ajo që tani kryesisht po përpiqen të bëjnë qeveritë, është ngritja e kapaciteteve për të përballuar dhe sistemuar atë që shumë lehtë mund të jetë një tronditje demografike e kontinentit të vjetër. Në praktikë kjo sërish i bie se po merren me pasojat pa asnjë vullnet për tu involvuar në riparimin e "shkakut". "Pranvera

Arabe" e lënë e vetmuar nën mëshirën e klaneve diktatoriale dhe njëkohësisht me këtë ringjallja ushtarake ruse, tregon se ka arsye për tu frikësuar nga një serë liderësh evropian që nuk shikojnë më shumë se interesin e atypëratyshëm të shteteve që përfaqësojnë.

Dikur kishte një program të qartë që quhej "Politika Evropiane e Fqinjësisë", një instrument i cili mëtonte më shumë siguri kombëtare për Evropën, duke inkurajuar demokratizimin dhe stabilitetin në vendet përreth saj. Sot së paku dy shtete që ishin pjesë e këtij programi janë të rrënuara dhe janë ndër burimet kryesore të "krizës së migrantëve". Mosmarrëveshjet e brendshme, fragmentimet konceptuale lidhur me të tanishmen dhe të ardhmen, që moti e kanë bërë politikën e përbashkët të jashtme evropiane në nivelet e një iluzioni. Në ndërkohë, kur vetëm një ofensivë ushtarake ruse e fundvitit të 2019-s në zonat e Idlibit në Siri, lëviz valën prej së paku 80 mijë njerëzve që po ikin nga atdheu i tyre, kuptohet akoma më qartë se kanë humbur krejtësisht ndjeshmëria, vullneti dhe forca reale që Evropa të jetë një aktore serioze në politikën ndërkombëtare.

## Koordinatori Hoti shpërblen shkollën më të mirë, personelin arsimor dhe DKA-të

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, në një ceremoni ka ndarë shpërblimet për organizuesit dhe pjesëmarrësit në garat e Programit Nacional për Rininë, duke i përshirë të tria nivelet, si ato shkollore, komune e republike.

Me këtë rast koordinatori Hoti ka thënë se ka përmbushur të gjitha premtimet që janë dhënë në raport me shpërblimet. "Jeni dëshmitarë se bashkë me mijëra burra e gra të Republikës së Kosovës kemi bërë gara nacionale pa u kompensuar as edhe një cent dhe, mbi të gjitha, kemi arritur t'i vëmë në pah 44 723 fitues në nivel republike. Ju keni dëshmuar se arsimit në Kosovë ka shumë probleme, por që komuniteti i arsimit e ka energjinë e vet për të bërë punë vullnetare dhe për të dëshmuar se është aty idealizmi i saj për ta vënë arsimin në binarët që duhet të jetë. Sado që ka telashe, arsimit jemi në të gjithë së bashku, me pjesët e bukura, me heroizmin e pjesët jo të mira të tij. Ne nuk mund të krijojmë arsim të mirëfilltë pa investuar jo vetëm te nxënësit, por edhe te nxënësit, mësimdhënësit e DKA-ja", ka



thënë Hoti. Koordinatori Hoti ndau shpërblimet për 24 komuna. Shkolla më e mirë, që është shpërblyer

me 10 000 euro, është "Prenk Jakova" në Gjakovë. Drejtoritë komunale të arsimit të të gjitha komunave ku janë mbaj-

tur garat i kanë përzgjedhur mësimdhënësit, drejtorët, prindin dhe përfaqësuesin e komunitetit artistik më të mirë,

ndërkaq shkolla më e mirë, personat me kontribute të veçanta si dhe DKA-të më të mira janë zgjedhur në nivel vendi.

# SIGMA

## VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
  - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
  - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
  - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
  - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
  - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
  - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
  - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
  - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
  - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## Netanjahu edhe një mandat në krye të partisë

TEL AVIV, 27 DHJETOR - Kryeministri izraelit Benjamin Netanjahu fitoi bindshëm në zgjedhjet për kreun e partisë "Likud". Ai mori 72 për qind të votave duke mposhtur kështu kundërshtarin e tij Gideon Saar. Rezultati forcon pozitat e Netanjahut për zgjedhjet e treta të përgjithshme që mbahen në Izrael brenda një viti, të planifikuara për në fillim të muajit mars. "Kjo është një fitore e madhe. Falënderoj anëtarët e "Likud-it" për besimin, mbështetjen dhe dashurinë", tha kryeministri izraelit në një mesazh për përkrahësit, duke u

zotuar se do ta udhëheqë partinë drejt një fitoreje të madhe në zgjedhjet e ardhme kombëtare dhe se do të vazhdojë ta udhëheqë Izraelin drejt arritjeve të reja.

Kundërshtari i tij, Gideon Saar, tha se do të vazhdojë të mbështesë "Likud-in" në fushatën e ardhshme zgjedhore. Pritshmëritë ishin që Saar të merrte 30 për qind të votave. "Gara ishte jetike për partinë "Likud" dhe karakterin demokratik të partisë", tha Saar i cili shtoi se vendimi i tij për të kandiduar i domosdoshëm. "Kush nuk është i gatshëm të

ecë në rrugën që beson, nuk do të fitojë kurrë", tha ai.

Saar shihej si sfiduesi i parë serioz i kryeministrit izraelit në 10 vjet.

Ditë më parë Benjamin Netanjahu u bë kryeministri më jetëgjatë në historinë e Izraelit. Rezultati i votimeve tregon se mbështetja ndaj tij nuk është zbehur edhe pas padisë së ngritur ndaj tij për tri raste korrupsioni.

Në fushatën e fundit zgjedhore Netanjahu përdori stilin e presidentit të Shteteve të Bashkuara, duke sulmuar median dhe sistemin e drejtësisë. Ai e cilësoi



procesin hetimor ndaj tij, si qesharak, duke këmbëngulur në pafajësinë e tij. Disa analistë në Izrael thonë se

Netanjahu ka si qëllim t'i fitojë zgjedhjet e përgjithshme në përpjekje që të sigurojë imunitet prej hetimeve.

# Turqia do të dërgojë trupa ushtarake në Libi, pavarësisht paralajmërimit rus

Moska ka paralajmëruar Turqinë kundër pozicionimit të trupave në Libi, mirëpo Erdogan ka kundërshtuar kritikën ruse dhe ka thënë se Turqia nuk do të qëndrojë e heshtur ndaj mercenarëve të lidhur me Kremlinin, që supozohet se luftojnë në kombin e Afrikës Veriore

ANKARA, 27 DHJETOR - PRESIDENTI i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se shteti i tij do t'i dërgojë trupat ushtarake në Libi me kërkesë të Tripolit nga muaji janar, një hap që mund ta përballë këtë vend me mercenarët e lidhur me Kremlinin, që supozohet se luftojnë në kombin e Afrikës Veriore.

Një zyrtar i Tripolit ka konfirmuar kërkesën zyrtare që i është bërë Ankarasë për mbështetjen e forcave ushtarake, tokësore, ajrore dhe detare të Turqisë.

Qeveria e Libisë e njohur nga Kombet e Bashkuara në Tripoli është duke u sfiduar në kontrollimin e vendit si pasojë e Ushtrisë Kombëtare të Libisë të generalit, Khalifa Haftar, i cili është raportuar se mbështetet nga Rusia, Kina, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Jordania, ka njoftuar rfe.

Qeveria e Libisë është krijuar më 2016 në kuadër të një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara, me që në Libi ishte krijuar kaos, pas

largimit nga pushteti të diktatorit, Muammar Qaddafi më 2011.

Moska ka paralajmëruar Turqinë kundër pozicionimit të trupave në Libi.

Mirëpo Erdogan ka kundërshtuar kritikën ruse dhe ka thënë se Turqia nuk do të qëndrojë e heshtur ndaj mercenarëve që mbështesin Haftarin, të cilët i takojnë kompanisë private të sigurimeve, Wagner, të lidhur me Kremlinin.

Moska nuk ka konfirmuar prezencën e grupit Wagner në Libi dhe as nëse mbështet këta luftëtarë.

Diplomatët kanë thënë se luftëtarët e Haftarit nuk kanë arritur në Tripoli, mirëpo gradualisht kanë avancuar në zonat jugore me ndihmën e forcave ruse dhe atyre sudaneze.

Ndërkohë Shtëpia e Bardhë ka thënë se presidenti amerikan, Donald Trump ka zhvilluar një bisedë telefonike me presidentin e Egjiptit, Abdel Fattah al-Sisi, të cilët kanë "kundërshtuar" shfry-



tëzimin e forcave të huaja", pa përmendur në mënyrë specifike ndonjë vend. "Liderët janë paj-

tuar që palët duhet të marrin masa urgjente për të zgjidhur konfliktin para se banorët e

Libisë të humbin kontrollin ndaj aktorëve të huaj", ka thënë mes tjerash Shtëpia e Bardhë.

## Rrëzohet avioni Kazakistan, 12 të vdekur

KAZAKISTAN, 27 DHJETOR - Një aeroplan me më shumë se 90 persona në bord u rrëzua të premten në Kazakistan duke shkaktuar vdekjen 12 vetëve ndërsa 20 të tjerë u plagosën rëndë. Incidenti ndodhi herët në mëngjes, pak minuta pas ngritjes së avionit.

Në një deklaratë të Komitetit të Aviacionit Civil të Kazakistanit

thuhej se aeroplani i linjës ajrore "Bek Air" goditi një rrethojë betoni dhe një ndërtesë dykatëshe pas ngritjes nga aeroporti ndërkombëtar Almaty. Autoritetet lokale thanë fillimisht se bëhej fjalë për 15 të vdekur, por Ministria e Brendshme publikoi më pas një shifër më të ulët, pa dhënë asnjë shpjegim. Avioni ishte nisur drejt krye-

qytetit Nur-Sultan.

Autoritetet e Kazakistanit njoftuan se të gjitha fluturimet e kompanisë "Bek Air" si dhe ato të tipit "Fokker-100" janë pezulluar ndërsa kanë nisur hetimet mbi incidentin.

Prodhuesi i avionëve "Fokker-100" falimentoi më 1996 dhe një vit më vonë prodhimi i këtij tipi aeroplanësh u ndal.



# Qazim Ilaz Shehu - Çlirimtari që luftoi në Koshare për Bashkimin e tokave shqiptare



**Shkruan: Afrim MUSTAFA - Veteran dhe ish reporter i luftërave të UÇK-së**

Në Kosharen e krenarisë kombëtare, kishte shkuar për të luftuar edhe trimi i paepur nga Shkupi, Qazim Ilaz Shehu ( 26 dhjetor 1977-27 gusht 2016 ), i

cili iu bashkua lavdisë së UÇK-së në moshën 21 vjeçare. Ne fillimvitin 1999, Qazimi kishte vendosur të shkojë në Shqipëri, ku bashkohet me bashkëluftëtarët dhe të organizuar hynë si çlirimtarë në Kosharën Legjendare. Atje, i pret udhëheqja e Brigadës , 138, "Agim Ramadani", e cila zhvilloj lavdi dhe epike për Kosovën... Ishte krenar që, Qazimi po luftonte krahpërkrah me atdhetarët më të veçantë të trojeve shqiptare, te cilët në Koshare armikut gjakatar serb i dhanë goditje shekullore. Qazim Shehu, ishte i vetmi djalë i babës Ilaz dhe



nenës Ifeta Shehu dhe vëlla i vetëm i tri motrave.. Fatmire Nafije dhe Kosovare. Por, kjo nuk e kishte ndalur asnjëherë, që të armatoset dhe te luftoëj për Kosovën. Pas fitores së lirisë së Kosovës ishte tepër lumtur dhe krenar. Por , sapo doli e lavdishmja e radhës, UÇK në Maqedoni, ky trim i rrallë i bashkohet prapë, radhëve të lavdisë. Ishte ndër ushtarët më të veçantë të UÇK-së, , nën komandën e gjeneralit të mirënjohur dhe të pavdekshëm të UÇK-së, Ali Ahmeti. Pushteti maqedonas nuk e linte të qetë Familjen e Ilaz Shehut në Shkup,

e cila këtu kishte ardhur nga Gremja e Ferizajit në fillim të viteve gjashtëdhjetë. Policia maqedonase e kishte përndjekur në vazhdimësi familjen kryengritëse të trimit të UÇK-së. Përshkak të paprespektivës, para disa vjetësh shkoi në Itali, për të punuar. Por, më 26 Gusht të vitit 2016 vdiq në mërgimin e Largët, në Padova të Italisë, për të mos vdekur kurrë. Është varrosur ne vendlindjen e babait, në Greme të Ferizajit, ku me kontribut të qytetarëve, të Veprimtarit Gilbert Demi nga Zhegra dhe me përkrahjen edhe të Kryetarit të Ferizajt, Agim Aliu i është ngritur

një pllakë nderimi dhe përkujtimi. Kontribut për sjelljen ne Kosovë nga Italia, të trupit të çlirimtarit të paepur, Qazim Ilaz Shehu dhanë Istucionet e Republikës së Kosovës, bashkëluftëtari, Bekim Dardhishta nga Shkupi dhe tezja e Qazimit, Ismeta Kecap , e cila gjendet në Australi. Familjen Shehu , sa jetoj në Kosovë e kishte përkrahur edhe, Perparim Kosumi nga Burrniku, me vendbanim ne Greme... Gjaku, Heroizmi, Trimëria dhe Lavdia e Atdhetarit dhe Çlirimtarit, Qazim Ilaz Shehu, kurrë nuk Vdes..





# Viti 1949: 'Provokacionet' greke dhe tradhtia e madhe

## Cilat janë ngjarjet që kanë shënuar shqiptarët dhe botën në vitin 1949?

Në Kosovë nuk ndodhë asgjë me rëndësi, pos që vazhdon dhuna ndaj shqiptarëve të cilët tashmë janë të izoluar edhe nga Shqipëria. Pas prishjes së raporteve me BRSS-në (për çka prishen edhe raportet Shqipëri-Jugosllavi), amerikanët nisnin të dërgojnë shuma të mëdha parash për zhvillimin e Jugosllavisë. Për dallim, Shqipëria zgjodhi të mbështeste regjimin mizor të Josif Stalinit dhe të BRSS-së ku populli jetonte në terror. Pra, zgjodhi mjerimin.

Në Shqipëri shpallet Dekreti i Komuniteteve Fetare, si hapi i parë i komunizmit në luftën kundër religjioneve. Sipas dekretit, kërkohet besnikëria e plotë e klerit ndaj shteteve dhe udhëheqësve shtetërorë, në të kundërtën shteti merrte masa si ndaj klerikëve të veçantë ashtu edhe ndaj komuniteteve. Po ashtu, shteti miratonte emërimin e klerëve të lartë fetarë e madje kishte të drejtë të bënte emërimet dhe të ndërhynte në jetën e komuniteteve fetare. Lufta më e madhe bëhej ndaj klerit katolik.

Më 2 gusht 1949, Greqia sulmon Shqipërinë, por grekët hasin në rezistencë. Ky konflikt i armatosur që zgjati deri më 5 shtator e ku pati

qindra të vrarë e të plagosur (si nga pala shqiptare ashtu edhe ajo greke), nga historiografia shqiptare dhe nga propaganda e regjimit komunist është njohur si "Provokacionet e gushtit 1949"!

Thuhet se grekët sulmuan me mbi 70 mijë forca të armatosura, mbi 50 aeroplanë, 80 tanke dhe një skalion artilerie me afro 400 gjuajtës – kryesisht topa. Shteti shqiptar raportohet të ketë mobilizuar dhe futur në luftën mbrojtëse 10 mijë ushtarë, ndërkohë që mbante në gatishmëri edhe 30 mijë të tjerë pranë zonës së sulmuar. Ky sulm nga shumëkush cilësohet si tendencë e radhës greke për ta pushtuar Epirin Verior.

Në një Komunikatë Operative të Ministrisë së Forcave të Armatosura të Republikës Popullore të Shqipërisë, të lëshuar më 3 gusht 1949, "heroizmi" shqiptarë kështu propagandohej: "Mbas shtatë orë luftimesh shumë të ashpra me repartet e rojës së kufirit të Divizionit të Mbrojtjes Popullit, mundën të hyjnë në thellësi të tokës sonë deri 300-400 metro duke marrë kuotën 1309 dhe të rrahin me artileri katundin

Vidohovë. Forcat tona në ora 18:30 sulmojnë monarko-fashistët që kishin hyrë në tokën tonë, i ndjekin deri në kufi dhe vendosin situatën". Ndërkaq, në një komunikatë të 6 gushtit thuhet: "Gjatë ditës 4 gusht 1949, monarko-fashistët grekë kanë vazhduar provokacionet e tyre të poshtira kundra vendit tonë në kufirin e jugut. Në sektorin e Bozhigradit dhe në drejtim të Leskovikut, n'afërsi të piramidave Nr. 11-12-13 e 14. E mbështetur nga artileria dhe aviacion, me forca superiore sulmuan kuotën 1425 dhe kuotën 1309. Kundrasulmet e forcave tona i thyen monarko-fashistët duke i nxjerrë jashtë kufirit".

Por, e vërteta është pak më ndryshe. Është kjo koha kur në Greqi po i vinte fundi Luftës Civile mes Ushtrisë Kombëtare Greke të mbështetur nga anglezët dhe amerikanët dhe Ushtrisë së Forcave Demokratike (komunistëve). Këta të fundit kishin mbështetje të madhe nga Shqipëria që s'e njihte takatin dhe rreziqet ku futej. Madje, Gjenerali Markos (Markos Vafeiadis), figura kryesore komuniste e Greqisë, kishte qenë disa herë në Tiranë ku ndër të tjera ka kërkuar çamë që të luftojnë përkrahë tyre – në kufi në malin Gramos. Kështu, në gusht sulmohen forcat e fundit partizane greke të cilat tërhiqen brenda territorit shqiptar. Kjo tërheqje dhe sulmi i 31 gushtit që mposhtë rezistencën në Gramos, shënon



Robërit grekë në Shqipëri



përfundimin e Luftës Civile të Greqisë.

Gjatë tërheqjes së forcave komuniste, në Shqipëri dërgohen edhe robërit e Ushtrisë Kombëtare. Këta robër u bashkuan me robërit që ishin zënë nga Ushtria e Republikës Popullore të Shqipërisë gjatë "provokacioneve". Bisedimet për lirimin e tyre ndeshën në vështirësi, sepse Tirana i akuzonte për hyrje në territorin e Shqipërisë, ndërsa Athina justifikohet se ata janë të burgosur janë kapur në territorin grek. Dorëzimi i tyre do të bëhet në gusht 1956.

Më 1949 Shqipëria ishte vendi më i varfër në Evropë dhe më besnik ndaj liderit sovjetik, Josif Stalin. Të gjitha shtetet në kufi me Shqipërinë, i kishin raportet e acaruar me BRSS-në. Kështu, CIA dhe SIS (MI6) bënë planin për ta rrëzuar Enver Hoxhën nga pushteti. Operacioni u quajt "Valuable". Nëse do të kishte sukses, do të përsëritej në vendet tjera satelite të Bashkimit Sovjetik. Për këtë operacion u kontaktuan Mit'hat Frashëri, Sait Kryeziu, Abaz Ermenji dhe Abaz Kupi. Dy të parët udhëhiqnin Komitetin "Shqipnija e Lirë" që u themelua në gusht të vitit 1949 në Paris.

Trajnimet e diversantëve që ishin nga të gjitha trojet etnike shqiptare, nën sekretin më të madh janë bërë në ishullin Gozo të Maltës. Pas ushtrimeve disajvëshe, më 28 tetor 1949 nisjet grupi i parë. Pastaj vazhduan grupet tjera. Por, shpejtë operacioni u ndërpre pasi dikush nga brenda po i pasonte informatat në Moskë e pastaj Moskë në Tiranë.

Informacionet për sulm kishin rënë në duar të agjentit të dyfishtë, Kim Philby. Pasi e lexoi raportin e tij sekret, Stalini ka thënë: "Desantët të asgjësohen para se të zbarkojnë në tokë!". Urdhri i ekzekutua fjalë për fjalë. Gazetari i mirënjohur australian-anglez, Phillip Knightley, ka qenë i vetmi gazetar perëndimor që ka mundur të intervistojë spiunin e KGB-së në Moskë, në vitin 1988. Në pjesën kur flitet për Shqipërinë, Philby ka thënë: "Luajta rol përcaktues në minimin e planit të hartuar nga Perëndimi për organizimin e një

masakre të përgjakshme në Shqipëri. Por, ata që e menduan dhe e planifikuan këtë operacion, gjithashtu, si dhe unë, mundësonin gjakderdhje për qëllime politike. Agjentët, që ata dërguan në Shqipëri, ishin të armatosur dhe të vendosur për të kryer akte sabotimi dhe vrasje. Prandaj, nuk ndjej keqardhje, që ndihmova në asgjësimin e tyre. Ata e dinin se ku po shkonin. Mos harroni se unë kohë më parë gjithashtu u implikova në likuidimin e një numri të konsiderueshëm hitlerianësh, duke dhënë kështu kontributin tim modest në fitoren mbi fashizmin".

Thuhet se gjatë këtij aksioni janë vrarë të paktën 300 diversantë. Për shumë vite ky ishte një nga sekretet më të mëdha të Luftës së Ftohtë. Detajet e operacionit u zbuluan tek në vitin 1984 kur Lord Nicholas Bethell e botoi librin e tij "Betrayed" (Të tradhtuarit). Në bazë të këtij libri, BBC bëri një program dokumentar të titulluar "Great Betrayal" (Tradhtia e Madhe).

Më 1949 nis edhe eliminimi i komunistëve shqiptarë që cilësoheshin si mbështetës të kryeministrit jugosllav, Josip Broz Tito. Koçi Xoxe shkarkohet nga posti i ministrit të Brendshëm dhe do të ekzekutohet bashkë me 14 anëtarë të Komitetit Qendror dhe 32 deputet të Kuvendit Popullor (25 për qind të kreerëve të lartë të Partisë së Punës).

Në janar 1949 përfundon lufta mes Indisë dhe Pakistanit, ndërsa Harry S. Truman jep betimin si presidenti i 33-të amerikan. Truman do të zbatojë Planin Marshal për rindërtimin dhe ringjalljen ekonomike të Evropës Perëndimore.

Po në janar dalin lajmet për misterin që do të njihen si "Doallia për Poe-n". Fjala është për varrin e shkrimtarit të madh amerikan, Edgar Allan Poe, ku nga viti 1930, sipas dëshmitarëve, çdo vit, në orët e para të 19 janarit – ditëlindjes së shkrimtarit – një person me maskë të zezë në fytyrë dhe me bastun me dorezë argjendi, i afrohet varrit të tij ku derdh një gotë të konjakut "Martell" dhe e ngre një doli. Pastaj vendosë tre trëndafila (Poe, gruaja e tij Virginia dhe vjehrra



**Spiuni Kim Philby**

Maria Clemm) dhe e lëshen e papërfunduar të konjakut. "Ceremonia" e tillë do të regjistrohet deri më 2009, për çka dyshohet se në të kanë marrë pjesë babë e bir. Më 10 shkurt do të jepet premiera e tragjedisë së Arthur Millerit, "Vdekja e shitësit", që konsiderohet si një ndër veprat më të mëdha të dramaturgjisë botërore të shekullit XX. Ajo godet Ëndrën Amerikane dhe materializmin perëndimor përmes trajtimit të fatit të një familjeje të shtresës së mesme. Në këtë familje asnjëri nuk është ai që shfaqet të jetë e aq më pak është ai që do të donte të ishte. Një temë aktuale edhe për ditët e sotme.

Më 7 shtator themelohet Republika Federale e Gjermanisë, ndërsa më 7 tetor Republika Demokratike e Gjermanisë.

Më 1949 lindin rokerët Robert Palmer, Billy Joel, Roger Taylor, Phil Lynott, Rick Springfield, Mark Knopfler, Bruce Springsteen dhe Lindsey Buckingham; filozofi majtist Slavoj Žižek; politikanët Massimo

D'Alema, Carl Bildt dhe Benjamin Netanyahu; aktorët Jessica Lange, Sigourney Weaver, Richard Gere dhe Jeff Bridges... dhe një nga ikonat më të mëdha të humorit në ShBA,

shqiptari John Belushi. Më 1949 vdes kompozitori dhe dirigjenti i famshëm Richard Strauss, si dhe kryeministri i shtatë i Shqipërisë, Pandeli Evangjeli. /Telegrafi/



**John Belushi**



**Pamje nga betimi i presidentit amerikan, Harry S. Truman**

E jashtëzakonshme

## Blen një orë të vjetër, gjen 50 000 marka

Një burrë nga Aurichi i Gjermanisë bleu një orë muri në treg, por kur e solli në shtëpi atë e priti një befasi. Ai nuk mund t'u besonte syve kur gjeti 50 000 marka gjermane brenda orës. Gjermani anonim e bleu orën në pranverë dhe paratë i dërgoi në Zyrën për Gjëra të Humbura, sipas Fenix Magazine. Në rast të paraqitjes së pronarit të parave, burri do të kishte të drejtën për tre për qind të fitimeve (rreth 770 euro), por



askush nuk u përgjigj dhe pas afatit ligjor prej gjashtë muajve, ai i mori paratë.

FOTO E DITES




Një burrë nga Bangladeshi shihet duke ngarë një biçikletë të mbushur me qese. /AFP/

E rrallë

## Barinjtë që e drejtojnë kopenë nga ajri

Për disa fermerë në Zelandën e Re, Australi e Britani, drejtimi i kopeve dhe grumbullimi i tyre ka nisur të bëhet nga qielli. Dronët kanë rezultuar të jenë shumë të dobishëm për ta bërë punën e bariut me saktësi. Një prej fermerëve e bleu dronin për të bërë fotografi, por vuri re që sapo ua afronte deleve ato shtyheshin njësoj



sikur t'ua kishte afruar një qen.

## BARSOLETA E DITËS



Një bionde shkoi në kopshtin zoologjik.

Rojtari:

- Urdhëroni, si mund t'ju ndihmoj?

Biondja:

- Policia më tha se merimanga ma ka marrë veturën, prandaj erdha ta marr.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

## The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

## FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

## FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

**Regjia:** James Mangold



## Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

**Rolet:** Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

**Regjia:** Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), **fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Mos u lodhni duke i këshilluar apo motivuar të tjerët, thjesht përqendrohuni në gjërat tuaja. Askush nuk është përgjegjësi juaj, kështu që nuk keni pse merreni fare me ata.



**DEMI**

Po bëni shumë gabim. Harrojeni armiqët dhe kushtojani kohën e lirë miqve tuaj. Përpiquni të mos jeni shumë mbizotërues në kohën që kaloni kohë me këta miq. Le të jetë një takim i përlur, i qetë dhe pa presion.



**BINJAKËT**

Nëse dikush që ju intereson kërkon t'ju sqarojë diçka apo t'ju kërkojë falje, sot është dita që t'i ndihmoni. Së pari hiqni dorë nga e kaluara dhe jepini këtij personi një shans më shumë.



**GAFORRJA**

Ju e dini se kush janë këta persona, por nuk do t'ju marrë mendja se ata do t'ju shkaktojnë disa dëme ditën e sotme. Ata duan që të kenë çdo gjë rreth vetes dhe egoizmi i tyre nuk do t'ju vijë aspak në ndihmë kur të keni nevojë.



**LUANI**

Aftësitë tuaja për t'i kapur gjërat që në ajër po ju bindin se ajo që po shihni nuk është aspak normale, prandaj tregohuni të kujdesshëm me kë merreni sot. Besoni vetëm njerëzit që e kanë dëshmuar veten si të besueshëm apo miq të sinqertë.



**IRGJËRESHA**

Herë pas here ju duhet të të zhyteni thellë në zemrën tuaj në mënyrë që ta shihni të vërtetën për atë që po ndodh përreth jush. Nëse mendoni se ju po ecni para në jetën tuaj duke bërë ndryshime për mirë atëherë vazhdoni kështu.



**PESHORJA**

Ju do të jeni të mbushur shumë me energji ditën e sotme dhe një listë e vogël e punëve që keni do t'ju duket shumë pak. Por, mos keni frikë sepse gjithmonë ka gjëra të tjera për të cilat mund të punoni.



**AKREPI**

Sot ju jeni fuqimisht rezatues. Mund të bëni ndryshime të mëdha në jetën tuaj nëse dëshironi. Është një kohë e mrekulueshme për të përzier pak gjërat dhe për të provuar një mënyrë tjetër jetese, duke u larguar pak nga monotonia juaj.



**SHIGJETARI**

Ndiqu zërin tuaj të brendshëm dhe bëni atë që mendoni apo dëshironi. Disa çështje po shfaqen gjithmonë në jetën tuaj dhe tani është koha që t'i jepni fund një herë e mirë.



**BRICJAPI**

Ndikimi juaj mbi rrethin tuaj shoqëror është rritur kohët e fundit dhe sot do të arrijë të jetë më i fuqishëm se kurrë. Trajtimi i të tjerëve ashtu siç dëshironi që ata t'ju trajtojnë është një mënyrë e sigurt për të fituar respekt.



**UJORI**

Nëse karriera juaj po shkon ashtu siç dëshironi që ajo të shkojë, atëherë mirë për ju! Merrni kohë dhe shijojeni. Ju mund të keni mundësi të vendosni gjërat vënd diini në një darkë të këndshme dhe të relaksoheni.



**PESHQIT**

Do të ketë disa peshkaqenë që notojnë në ujëra dhe një miku juaj do ta ketë nevojën për një paralajmërim dhe një këshillë. Syri juaj kritik nuk gabon aspak, prandaj të mbrosh apo të këshillosh njerëzit që keni përreth nuk ju kushton asgjë.

## "Jezusi ka lindur", Kanye West publikon albumin e ri



**K**anye West nuk ndalet. Ai në tetor ka publikuar albumin "Jezus është mbret". Ndërsa në Ditën e Krishtlindjes nxori albumin e ri "Jezusi ka lindur". Albumi ungjillor përfshin 19 këngë

dhe erdhi në bashkëpunim me Sunday Service. "Jezusi ka lindur" ka një qasje më tradicionale ndaj ungjillit sesa paraardhësi i tij ku u përfshinë elemente të hip-hopit dhe të muzikës elektronike.



## Jennifer Lopezi zbulon sekretin e fytyrës rrezatuese

Shumë e kanë zili lëkurën rrezatuese të aktores pesëdhjetëvjeçare dhe ajo thotë se sekretin e lëkurës së saj është, para se gjithash, një gjumë i mirë dhe cilësor. "Trupit së pari i duhet shumë gjumë. Është

më mirë të flemë nëntë ose dhjetë orë, por unë bëj çmos që të arrij të paktën tetë orë gjumë", ka thënë Jennifer Lopezi, duke shtuar se për një fytyrë të mirë duhen ngrënë edhe ushqime të freskëta.

## Tërbohen fansat, Madonna anulon koncertin dy orë para ngjitjes në skenë



**M**adonna ka zemëruar fansat e saj pasi anuloi koncertin në Miami. Fansat u zhgënjyen pasi Mbretëresha e pop vendosi që të mos performonte në turneun Madame X vetëm dy orë para shfaqjes. "Daily Mail" raporton se vendimi për anulimin e shfaqjes erdhi pasi ish-bashkëshorti i saj

Guy Ritchie paraqiti një mocion në çështjen e divorcit duke kërkuar "zbatimin ose ekzekutimin e një gjykimi ose urdhri" në Gjykatën Supreme të Manhattanit. Sipas mocionit, ka një mosmarrëveshje mes çiftit se ku do t'i kalojnë Krishtlindjet disa prej gjashtë fëmijëve të Madonnës.

## Travis Scotti publikon album të ri



**T**ravis Scott ka publikuar albumin e ri Jackboys. Reperi 27-vjeçar njoftoi se "paketa" e tij e re po vinte para vetëm pak ditësh. Albumi përmban versionin

e ri remiks të këngës së tij hit "Highest in the Room" në bashkëpunim me Rosalia dhe Lil Baby. Aty ka të përhurë edhe pesë emisione të tjera dhe një "intro".

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## Lorianës i ngritët për 350 dollarë Bursa Olimpikë

Loriana Kukës i është ngritur në 500 dollarë Bursa Olimpikë 'Tokio 2020' si rezultat i të arriturave në vitin 2019. Loriana është shprehur e kënaqur që ka marrë një përkrahje të tillë, kurse kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, pret që sukseset e xhudistes të jenë të mëdha edhe në vitin 2020



Kosovës, Agron Kuka. "Në emër të KOK-ut shprehu kënaqësinë që kemi mundësinë për ta ndërur kontratën me Loriana Kukën, e cila vjen si rezultat i arritjeve të saj të jashtëzakon-

shme, prandaj në mënyrë solemne po e bëjmë nënshkrimin e kontratës", ka deklaruar presidenti Hasani. Xhudistja Kuka e falënderoi KOK-un për mbështetjen e

vazhdueshme. "Është kënaqësi e madhe që kemi përkrahje të tillë", ka deklaruar ajo. I pari i FXHK-së, Agron Kuka, falënderoi presidentin Hasani, KOK-un dhe SO të KON-in që i kanë vlerësuar rezultatet e Lorianës. "Loriana e ka pasur një bursë, por me arritjen e rezultateve kulminante KOK-u ka marrë vendim për rritjen e mbështetjes, andaj uroj që Loriana të na gëzojë me rezultate edhe në vitin 2020", u shpreh Kuka. Krahas medalistës së bronzitë botërore, KOK-u, falë mbështetjes së SO të KON-it, ndanë edhe 17 bursa të tjera olimpikë "Tokio 2020", tri bursa olimpikë "Pekin 2022", ndërsa nga fondi i vet u ndanë nga 100 euro në muaj gjashtë Shpresave Olimpikë 2019.

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Loriana Kuka ka nënshkruar kontratën e re me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Solidaritetin Olimpik të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar për Bursën Olimpikë "Tokio 2020". Me propozimin e KOK-ut, xhudistes Kuka i janë ngritur të ardhurat nga Bursa Olimpikë "Tokio 2020", nga 150 dollarë në 500 dollarë në muaj. Ngritja e bursës vjen falë paraqitjeve të mira në

vitin 2019 ku Loriana Kuka (-78 kg) ka fituar medaljen e bronzitë në Kampionatin Botëror "Tokio 2019", si dhe medaljen e bronzitë në Lojërat Evropiane "Minsk 2019". Suksesi nuk i ka munguar as në garat Grand Slam e Grand Prix. Ajo ndodhet brenda normës olimpikë "Tokio 2020". Kontrata u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, xhudistja Loriana Kuka dhe kryetari i Federatës së Xhudos së

## Zeneli: Rikuperimi po ecën më mirë sesa kam menduar

REIMS, 27 DHJETOR - Futbollisti i skuadrës së Reimsit dhe përfaqësueses së Kosovës, Arbër Zeneli, vuan nga një lëndim tash e disa muaj, por duket se ai shumë shpejt do të jetë i gatshëm të kthehet në fushën e blertë. Në një intervistë për faqen zyrtare të Reimsit, Zeneli është përgjigjur në tri pyetje: e para që kishte të bënte me procesin e rikuperimit. "Rikuperimi po ecën më mirë sesa kam menduar. Stafi dhe skuadra më ndihmojnë shumë për rezultate më të mira. Në fillim unë nuk mund të bëja shumë dhe isha i frustruar, isha duke punuar vetëm me pjesën e sipërme të trupit. Pastaj, kur isha i gatshëm të vrapoja, ishte më e lehtë për evoluim", ka thënë Zeneli. "Unë mund të bëj maratonë, mund të vrapoj edhe me




ndryshime të drejtimit. Tani duhet të vazhdoj me qetësi dhe t'i bëj hapat finalë", ka shtuar Zeneli. Rikthimi i Arbër Zenelit para ndeshjeve të marsit do të

ishite një lajm i madh për Përfaqësuesen e Kosovës, e cila e zhvillon ndeshjen gjysmëfinale ndaj Maqedonisë Veriore në Shkup.

## Agjenti i Granit Xhakës: Kemi arritur marrëveshje me Herthan

LONDËR, 27 DHJETOR - Agjenti i Granit Xhakës, Jose Noguera, ka konfirmuar se 27-vjeçari do ta vazhdojë pjesën tjetër të sezonit në Bundesliga, te Hertha e Jurgen Klinsmann. Ai ka deklaruar se për këtë dëshirë të lojtarit janë njoftuar trajneri dhe drejtuesit e klubit, Xhaka dëshiron transferimin si të hapet afati kalimtar i janarit. Vendimi ka ardhur pas asaj që ndodhi me shqiptarin muaj më parë, ku u vërshtëllje në 'Emirates' dhe nga stadiumi u largua i zemëruar dhe duke bërë me gjepte kundër tifozëve. "Do të tregohem i sinqertë se kemi arritur marrëveshje me Herthan dhe do të donim të shkonim në Berlin. Këtë ia kemi thënë numrit një të klubit, Raul Sanlehi dhe drejtorit sportiv, Edu Gaspar, gjithashtu edhe trajnerit Mikel Arteta", ka thënë Noguera për "Blick". Xhaka u transferua tek Arsenali në vitin



2016 nga Borussia Monchengladbach. Ai deri më tani ka bërë 150 paraqitje me "Topçinjtë", ka shënuar 11 gola dhe ka dhuruar disa asistime.

## Trajneri i Çekisë: Ndeshja në Prishtinë ishte më emocionuese

PRAGË, 27 DHJETOR - Trajneri i Çekisë, Jaroslav Silhavy, në një intervistë të gjatë për mediat çeke ka rrëfyer emocionet e rrugëtimit për kualifikime në Kampionatin "Evropian 2020". Në pyetjen se cila ka

qenë ndeshja më emocionuese në këto kualifikime, ai ka thënë se ishte ajo me Kosovën në Prishtinë, kur ishin duke udhëhequr me rezultat 1-0, ndërsa u mposhtën 2-1. "Ndeshjet më emocionuese

ishin me Kosovën, ajo e zhvilluar në shtator, kur ne po udhëhiqnim 1-0, ndërsa në fund u mposhtëm me rezultat 2-1 në Prishtinë. Ai ishte rezultati më i keq i mundshëm për ne, pasi ne vështirësoi rrugëtimin për

kualifikim, madje edhe na i ndryshoi planet. Fatmirësisht disa ditë më vonë ne morëm fitoren ndaj Malit të Zi në udhëtim dhe kjo i ktheu gjërat në normalitet", ka thënë Silhavy.



## Nadali: Mos na krahasoni mua dhe Federerin me Messin dhe Ronaldon

MADRID, 27 DHJETOR - Rafael Nadal, numri 1 në botë për meshkuj në tenis, në një intervistë për "Marca" e ka quajtur jo të drejtë krahasimin që bëjnë se ai dhe Roger Federeri janë njësoj si Lionel Messi me

Cristiano Ronaldon. "Nuk ka asnjë shans që të bëhet ky krahasim, pasi janë dy sporte të ndryshme", ka thënë Nadal. "Cilësitë e Messit janë ndryshe nga ato të Federerit dhe kjo gjë vlen edhe për mua

e Cristiano Ronaldon. Secili ka cilësitë e tij të pakrah-sueshme me të një tjetri", u shpreh më tej tenisti spanjoll. Në lidhje me idenë për t'u bërë tenisti më i mirë në histori, Nadal ka deklaruar: "Kjo

gjë nuk më intereson. Unë jam që tani pjesë e historisë së tenisit dhe jam i lumtur për këtë. Kam punuar shumë që kur isha fëmijë dhe kam ndërtuar karrierën time bazuar te puna, stërvitja dhe sforcja".



## Dallasi fiton derbin ndaj San Antonios

DALLAS, 27 DHJETOR - Dallas Mavericksi e ka mposhtur me rezultat të ngushtë 102-98 San Antonio Spursin në derbin teksan. Diferencën në "American Airlines Center" për Dallasin e bëri i përhershmi Luka Donçiq. Talenti sloven regjistroi në total 24 pikë, 10 rebounde dhe 8 asistime duke udhëhequr Mavericksin drejt suksesit të 20 sezonal në 30 takime, me Dallasin që momentalisht mban vendin e 5-të në Konferencën e Perëndimit. San Antonios për ta evituar disfatën e 18 sezonale nuk i mjaftuan 21 pikët e DeMare DeRozanit dhe 18 të tjera të realizuara nga Rudy Gay. U rikthye menjëherë te fitorja Utah Jazz që vazhdon të bëjë paraqitje të mira në këtë sezon. Skuadra nga "Salt Lake City" regjistroi suksesin e 6-të në 7 takimet e fundit pasi mposhti me shifrat 121-115 Portland Trail Blazers, falë një periode të parë fantastike dhe falë edhe 35 pikëve të realizuara nga Mitchell. Në krahun tjetër Lillard dhe McCollum realizuan në total 59 pikë, por Portlandi pësoi humbjen numër 18 në 32 takime. Memphis Grizzlies prishi ecurinë pozitive të



Oklahoma City Thunderit pasi fitoi Chesapeake Energy Arena me rezultat 97-110. Një fitore për meritë të dyshes Jonas Valanciunas-Jaren Jackson Jr, të cilët së bashku realizuan 41 pikë. Më i mirë për City Thunderin ndërkohë ishte Chris Paul me 23 pikë, 96 rebounde dhe 11 asistime. I dha fund krizës prej pesë humbesh rresht Detroit Pistonsi që mposhti lehtësisht Washington Wizardsin me rezultat 132-102. Një fitore të madhe arriti Minnesota Timberwolves në

transfertën ndaj Sacramento Kingsit. Skuadra nga Minneapolis fitoi me shifrat 105-104 pas kohës shtesë një ndeshje shumë delikate duke koleksionuar fitoren e 11-të në 30 ndeshje.

### REZULTATET

Detroit - Washington	132-102
Brooklyn - New York	82-94
Dallas - San Antonio	102-98
Oklahoma - Memphis	97-110
Sacramento - Minnesota	104-105
Utah Jazz - Portland	121-115

## Khaka dhe Shaqiri në mesin e sportistët më të paguar në Zvicër

CYRIH, 27 DHJETOR - Ata janë mes futbollistëve më të vlerësuar në kombëtaren zvicerane, janë mes personazheve më të dashur për tifozët, por së fundmi egoja e madhe dhe ambicia i kanë përplasur në një konflikt për shiritin e kapitenit. Granit Khaka dhe Xherdan Shaqiri janë edhe mes lojtarëve më të paguar në federatën helveticë. Granit Khaka është i dyti në listën e prezantuar nga gazeta "Blik". Mesfushori i Arsenalit paguhet 13.2 milionë franga në vit, një kontratë e cila u negociua për shumë muaj me formacionin londinez. Granit Khaka lihet pas në listë nga Klinton Kapela, basketbollisti i Huston Roketsit që merr 15.2 milionë franga zvicerane falë akordit me gjigantët e NBA-së. Hokej dhe futbollit janë dy sportet që kanë më së shumti lojtarë, nga 4 gjithsej dhe basketbolli e tenisi kanë nga një përfaqësues. Mesfushori



i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, është i pesti në listën e sportistëve zviceranë më të

vlerësuar financiarisht me 7.93 milionë franga të fituara gjatë këtij viti.

### SHKURT

#### Muriqi kërkon shpëtimin nga Guardiola

Arijanet Muriqi u kthye në protagonist të Manchester City sa iu përket ndeshjeve në Kupë, duke bërë që emri i portierit të Kosovës të përmendet shumë nga mediat angleze. Por, sigurisht se ishte e vështirë për ta zënë vendin e titullarit të "qytetarët". Për këtë arsye u mendua huazimi te Nottingham Foresti, që luan në "Championship". Atje u mendua se Muriqi do të kishte vendin e titullarit, gjë kjo e cila ndodhi vetëm në ndeshjet e para. Së fundmi lojtari nuk është përfshirë as në futbollistët e grumbulluar, pa pasur asnjë shqetësim fizik. "Është vetëm një vendim i ynë, asgjë tjetër", u shpreh trajneri Lamouchi, që në këtë mënyrë e zhvlerëson Arijanet Muriqin. Në këto kushte ky i fundit pret thirrjen e Guardiollës në muajin janar, pasi situata është vërtet e keqe për të.

#### 'Marca': Sadiku, një surprizë e bukur te Malaga

Gazeta më prestigjioze në Spanjë, "Marca", vlerëson Armando Sadikun. Sulmuesi i kombëtares shqiptare ka rigjetur formën e tij optimale në Spanjë me transferimin te Malaga në Segunda Division, gjatë verës së shkuar. Sadiku ka arritur të realizojë 7 gola në këtë kampionat me skuadrën andaluziane dhe "Marca" duke analizuar paraqitjet e sulmuesit shqiptar thekson se ai është një surprizë e bukur në këtë edicion, madje ka kaluar edhe pritshmëritë. Paraqitjet e shqiptarit janë surprizuese pasi nuk pritej duke menduar paraqitjet që ka bërë dikur me Levanten. Megjithatë, në Spanjë janë skeptikë për paraqitjet e Sadikut, për faktin se i ka dhënë skuadrës pak pikë. Drejtuesit e Malagës kanë nisur punën për të gjetur edhe një tjetër sulmues që mund të bëjë mirë.

#### Guardiola: Aguero është i pazëvendësueshëm në City

Trajneri Pep Guardiola nuk ka kursyer lëvdatat për yllin e Manchester Cityt, Sergio Aguero. Aguero, golashënuesi më i mirë në histori të Cityt, ka edhe 18 muaj kontratë të mbetur dhe trajneri i tij mendon se influenza e lojtarit në fushë nuk mund të zëvendësohet. Trajneri katalan beson se 'Citizens' nuk do të jetë i gatshëm ta zëvendësojë lojtarin kur ai të largohet nga klubi. "Zëvendësimi i Aguero do të jetë më i vështirë. Sergio është i pazëvendësueshëm. Ne kemi një tjetër sulmues të mrekullueshëm (Gabriel Jesus) dhe, ndoshta, edhe një do të afrohet kur Sergio të largohet, por ai është i pazëvendësueshëm", ka thënë Guardiola. "Momenti më i rëndësishëm në këtë klub, më i rëndësishëm sesa kur klubi ta fitojë Ligën e Kampionëve, është kur Sergio shënoi golin kundër QPR-së", ka shtuar Pep.

#### Mourinho: Unë e di të ardhmen e Eriksenit

Christian Eriksen flitet prej kohësh se mund të largohet nga Tottenhami, pasi dëshiron të nisë një aventurë të re. Mesfushori i përfundon kontratën verën e ardhshme dhe shpeshherë e ardhmja e tij është lidhur me një kalim të mundshëm te Real Madridi. Për këto zëra ka folur edhe tekniku i Tottenhamit, Jose Mourinho, i cili në një intervistë të dhënë së fundmi është shprehur se e di të ardhmen e futbollistit, por nuk mund ta thotë. "Unë e di të ardhmen e Eriksenit, ose më saktë mendoj se e di. Komunikimi i tij me mua është plotësisht i hapur dhe i sinqertë, ne i besojmë shumë njëri-tjetrit. Unë e di të ardhmen e tij, por nuk do të jem unë ai i cili do ta zbuloj atë. I takon lojtarit vetë të flasë për të ardhmen e tij. Do ta marrë ai vendimin për ta bërë atë, jo unë", ka thënë Mourinho.

**Invitation for Bids  
Without Prequalification**

**KOSOVO**  
**WATER SECURITY AND CANAL PROTECTION PROJECT**  
**Credit No: 5902-XK**  
**Contract Title: Rehabilitation Works for Iber Lepenc Canal**  
**Reference No: WSCP-W-ICB-1**

The *Government of Kosovo* has received financing from the World Bank toward the cost of the *Water Security and Canal Protection Project*, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for *Rehabilitation Works for Iber Lepenc Canal*.

The *Iber Lepenc Company (ILC)* now invites sealed bids from eligible bidders for the **Rehabilitation of Iber Lepenc Canal**, including inter alia the following key works:

- Earthworks and Clearing
- Canal Rehabilitation
- Water Bypassing
- Buffer Reservoir
- Concrete Works and Utilities
- Service Roads

The goal is to repair and rehabilitate the open parts of the Canal to reduce the water losses due to deterioration over the last 40 years and to keep the function of the Canal sustainable. The canal is approximately 49km long and passes the 4 Municipalities Zubin Potok, Mitrociça, Vushtrri and Obiliç. The open parts of the Canal have a length of approximately 21 km. The underground parts of the Canal will be rehabilitated in a later stage, which is not part of this contract.

The period of construction is 22 months.

Bidders with the following minimum key qualifications are eligible for contract award. The Bidder shall furnish documentary evidence that it meets the following experience and financial requirements:

- Past contract experience of at least 1 similar contract of minimum value **11,000,000 Euro inclusive of VAT**. Similar contracts shall be based on canal lining/water conveyance systems of similar or larger conveyance capacity (e.g. irrigation, sewerage, storm drainage, bulk water supply or other similar hydraulic works) (including canals/aqueducts)
- Minimum average annual construction turnover of **Euro 15,000,000** or equivalent, calculated as total certified payments received for contracts in progress and/or completed within the last 3 years, divided by 3 Years. For this purpose **Years 2016, 2017 and 2018** will be used.
- Access to, or has available, liquid assets, lines of credit, and other financial means (independent of any contractual advance payments) estimated as **Euro 2,000,000** or equivalent for the subject contract net of the Bidders other commitments (this shall also include at least **1,000,000 Euro** as cash availability in bank or a confirmation from a bank to offer a valid line of credit from bank for the subject contract)
- Minimum specific construction experience in the following key activities successfully completed:
  - (a) Bridge construction (single lane concrete road bridges, span width 12 meters), at least 5 objects
  - (b) Retaining wall construction (minimum 3.8 km or 3,800 m<sup>3</sup>)
  - (c) Repair of concrete hydraulic structures (weathered with cracks and damaged reinforcement), surface 5,000 m<sup>2</sup>

For the following specialized works, the Employer permits specialized sub-contractors:

- Polyuria application / equivalent plastic resin application of aquatic structures (including canals/aqueducts) of at least **2 projects**, each of minimum value **500,000 EURO** or at least 1 contract of at least **1,000,000 EURO**
- Hydraulic duct bypass works for canal repair with no canal flow interruption, at least **2 projects** each of minimum value with **1,000,000**

2

Section X. Contract Forms

**Euro** or at least **1 contract** with at least **1,500,000 Euro**

Bidding will be conducted through the International Competitive Bidding procedures as specified in the World Bank's *Procurement Regulations: Procurement in Investment Project Financing – Goods, Works, Non Consulting and Consulting Services – July 2016, Revised November 2017 and August 2018*, and is open to all eligible bidders as defined in the Procurement Regulations. In addition, please refer to paragraphs 3.14 and 3.15 setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Interested eligible bidders may obtain further information from:

**HE "Iber Lepenc" JSC**  
**No 13 Bill Clinton Avenue,**  
**Pristina, Kosovo**  
Attention: Vigan Sylja (Project Coordinator – WSCPP)  
Telephone: + 383 38 525 006  
Email: [vigan.sylja@iber-lepenc.org](mailto:vigan.sylja@iber-lepenc.org)

With cc to: [fhadja@gmail.com](mailto:fhadja@gmail.com) and [dmajumdar123@yahoo.com](mailto:dmajumdar123@yahoo.com) and [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

and inspect the bidding documents during office hours from **9 am to 4 pm on normal working days between Monday to Friday** at the address given below.

A complete set of bidding documents in **English** language may be purchased by interested eligible bidders upon the submission of a written application to the address below and upon payment of a nonrefundable fee of **Euro 200**. The method of payment will be cash payment or bank transfer to:

User: **NH IBER LEPENC SHA - WB**  
Bank: **BANKA KOMBITARE TREGTARE - KOSOVA**  
Account number: **1901 2179 3504 1302**  
Swift code: **NCBAXKPR**  
IBAN: **XK051901217935041302**

The document will be hand delivered to the Bidder or be sent by courier to the address specified by the Bidder if specifically requested by the Bidder. For the convenience of Bidders an electronic copy of the Bidding Documents may be sent to Bidders who request for the same at the email address indicated by the Bidder. The electronic copy of the Bidding Document will be issued to Bidders after receipt of bidding document purchase payment confirmation details from the Bidder

Bids must be delivered to the address below on or before **18 February 2020 (10.00 Hours)**. Electronic bidding will not be permitted. Late bids will be rejected. Bids will be publicly opened in the presence of the bidders' designated representatives and anyone who choose to attend at the address below on **18 February 2020 (10.00 Hours)**.

All bids must be accompanied by a **Bid Security of Euro 200,000**.

The address referred to above is:

**HE "Iber Lepenc" JSC**  
**Protocol Office**  
**No 13 Bill Clinton Avenue,**  
**Pristina, Kosovo**  
Attention: Vigan Sylja (Project Coordinator – WSCPP)  
Telephone: + 383 38 525 006



**NJOFTIM - KËRKESË PËR OFERTË**

**Lipjan, 28.12.2019**

Titulli: **FURNIZIM ME PAJISJE**

**AUTORITETI KONTRAKTUES: "MAGIC ICE JOINT STOCK COMPANY" SH.A.**

**I. LËNDA E MARRËVESHJES**

**Furnizim dhe instalim:**

Lot 1. Furnizim dhe instalimi i pajisjeve për trajtimin e ujerave

Lot 2. Furnizim dhe instalim i rezervarëve për pranimin, ruajtjen dhe ftohjen e qumështit

Lot 3. Furnizim dhe instalim i pajisjeve për klimatizim për njësinë përpunuese të qumështit

**Vendi për ekzekutim:** Zona Industriale, Lipjan

**KUSHTET PËR OPERATORIN EKONOMIK I CILI DËSHIRON TA MARR TENDERIN**

**Kushtet e ofertës:**

**Afati kohorë:** Dorëzimi i ofertës duhet të bëhet deri më datën 11.01.2020, ora 16:00

**Vendi:** Zona Industriale, Lipjan

**Periudha e vlefshmërisë së tenderit:** 120 ditë prej afatit të fundit

**KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS:** Çmimi më i ulët dhe tenderuesi i përgjegjshëm

**II. KËRKESA PËR DOSJEN E TENDERIT**

Dosja e tenderit mund të kërkohej me shkrim përmes e-mailit nga operatorët ekonomik në autoritetin kontraktues ose direkt në zyrat e kompanisë "Magic Ice", më së largu deri më 07.01.2020 dhe duhet të specifikohet se për cilin Lot.

**Informata:** Për më tepër informata referoju drejtpërdrejt zyrës së kompanisë "Magic Ice, Zona Industriale, Lipjan; tel: 049/125604, 044/403343 email: [info@magicice.net](mailto:info@magicice.net)

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "MELLON SOLUTIONS" DOOEL-KOSOVO BRANCH, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 330240850 dhe nr. fiskal: 810829591 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Korporat që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MELLON SOLUTIONS" DOOEL-KOSOVO BRANCH, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : 330204850 i broj fiskala: 810829591 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "MELLON SOLUTIONS" DOOEL-KOSOVO BRANCH, has come to the decision to quit its business:330204850, i number fiskal: 810829591 The company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

**SWISS**  
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

► Dr. Çelë Shaban Alijaj shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të mjekësisë me numër të protokollit: 11/597 të datës 27.06.1979.

► "ZANZI JAZZ BAR" - NM, SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. unik identifikues 810853152, numri i biznesit 71206297 dhe nr. Fiskal 601529334.

► Shpresa Istrefi shpall të pavlefshëm diplomën e shkollës së mesme "Abdyl Frashëri" në drejtimin Agro Ekonomi.

► Shaban Salihaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Abdyl Frashëri" në drejtimin Agro Ekonomi.

► Kadrije Lahu shpall të pavlefshme diplomën e kolegjit " Biznesi " me numër 37/16 të programit : Master i arteve në menaxhment dhe financa.

► Valentina Ramadan Sejdiu shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit Ekonomik të UP-se, Bachelor Prishtinë.

► Kadrije Lahu shpall të pavlefshme dëftesën e kolegjit të Biznesit me nr: 37116 të programit master të arteve në menaxhment dhe financa.

► Kadrije Lahu shpall të pavlefshme diplomën e kolegjit të biznesit baxhelor i arteve në menaxhment dhe ekonomi.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterinikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.


► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.

# KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!

## BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqët tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



## ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



## PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

## GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN


Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



Tash kur e kemi lansuar skemën pilotuese për të ndihmuar mijëra familje kosovare të arrijnë eficiencë të energjisë, po ju japim 5 këshilla që do t'ju ndihmojnë të keni festa sa më eficiente.

## DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



## MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përfutur nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiencë të energjisë.